FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 102

Tiranë – E mërkurë, 11 korrik 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 5.7.2018	Për vlerësimin e veprimtarisë së Radiotelevizionit Shqiptar për vitin 2017	6403
Rezolutë e Kuvendit datë 5.7.2018	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2017	6404
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 409, datë 4.7.2018	Për rishpërndarje fondesh të infrastrukturës vendore dhe rajonale, nga fondi shqiptar i zhvillimit në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	6406
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 4.7.2018	Për caktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si organin e interesuar dhe autorizimin e saj për të lidhur shtesë kontrate, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, me firmën avokatore "Gowling WLG", për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar kundër shoqërisë "Hydro S.R.L.", ICC 22919/GR	6407
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 412, datë 4.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Sistemim, asfaltim i sheshit midis pallateve në lagjen 'Skënder Libohova', Lushnjë"	6407
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 413, datë 4.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV", Fier	6408
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 4.7.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV", Velipojë	6409

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 415, datë 4.7.2018	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.12.2016, për çështjen "Molla kundër Shqipërisë" (kërkesa nr. 29680/07).....	6410
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 4.7.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 443, datë 16.6.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor (ALBIS)".....	6411
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 4.7.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 788, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, standardeve dhe procedurave të procesit të akreditimit të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë", të ndryshuar.....	6419
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 4.7.2018	Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.....	6420
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 25.6.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Ediani" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Shëngjon 1", me fuqi të instaluar 651 kw; "Shëngjon 2", me fuqi të instaluar 356 kw dhe "Shëngjon 3", me fuqi të instaluar 341 kw, me fuqi totale 1348 kw.....	6423
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, datë 25.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Osoja HPP" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Osoje", me fuqi të instaluar 1922 kw..	6424
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 136, datë 25.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 130, seria PV11K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: "Slabinja 2a", me fuqi 2 mw; "Slabinja 2b", me fuqi 1.6 mw; "Slabinja 2c", me fuqi 1.8 mw; "Slabinja 2d" dhe "Slabinja 2e", me fuqi 3.4 mw, me fuqi totale 13.8 mw.....	6425
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 137, datë 25.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Energia Gas and Power Albania", për modifikimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 322, seria F15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015.....	6427
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 25.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike me nr. 158, seria T14, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014.....	6428
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 139, datë 25.6.2018	Për mospranimin për shqyrtim të aplikimit të shoqërisë "Kamenica HPP" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kamenicë", me fuqi të instaluar 800 kw.....	6429

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 140, datë 25.6.2018	Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 88, datë 6.8.2008, për licencimin e shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k., me nr. 62, seria NPM08P, në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike Kavajë.....	6430
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 141, datë 25.6.2018	Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 110, datë 16.9.2008, për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., me nr. 65, seria NPM08P, në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara.....	6431
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 142, datë 25.6.2018	Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 8, datë 4.2.2009, "Për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike", të ndryshuar.....	6432
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 25.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Fushë-Arrëz", me fuqi të instaluar 1990 kw.....	6434
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 144, datë 25.6.2018	Mbi rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017.....	6435
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 145, datë 25.6.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Furnizuesi i tregut të lirë" sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	6440
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 146, datë 25.6.2018	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2018.....	6441
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 148, datë 28.6.2018	Mbi kërkesën e OSHEE sh.a., për kontestimin e vendimit nr. 110, datë 14.5.2018, të bordit të ERE-s, lidhur me korrigjimin e faturave për shërbimin e balancimit, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përllogaritjeve nga OST sh.a., të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2017".....	6442
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 149, datë 28.6.2018	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "DON – UCD" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	6445

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë:

- Vlerëson se RTSH-ja është duke u zhvilluar në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e shprehjes së interesave të publikut dhe rifitimin e besimit të tij te ky transmetues;

- Thekson rolin kyç të RTSH-së jo vetëm në progresin e deritanishëm të procesit të digjitalizimit të rrjeteve të veta, por edhe të transmetimeve të mediave të tjera që mbështeten në të;

- Përshëndet përpjekjet e RTSH-së për transformim programor dhe organizativ, me qëllim ofrimin e programeve gjithëpërfshirëse me cilësi dhe në respektim të vlerave kombëtare e shoqërore;

- Kuvendi i Shqipërisë në ushtrimin e funksioneve të veta kushtetuese-ligjore, ndjek me vëmendje zhvillimet e RTSH-së dhe shpreh mbështetjen e tij në proceset aktuale që po zbaton RTSH-ja në drejtim të garantimit të pavarësisë editoriale, përmes forcimit të transparencës, llogaridhënies së RTSH-së para taksapaguesve të vet, si dhe rritjen e audiencës dhe besimit te publiku.

Kuvendi vlerëson arritje gjatë veprimtarisë së RTSH, për vitin 2017, sa i takon:

1. Nivelit të përmbushjes së kërkesave të rezolutës së Kuvendit për vitin 2017.

2. Gjatë vitit 2017, RTSH-ja ka një realizim aktivitetesh në mënyrë të kënaqshme në treguesit e përgjithshëm të prodhimit, treguesit ekonomiko-financiarë, si dhe në reformimin strukturor e programor, duke orientuar në shumë platforma dhe kanale të reja të pasqyrimit të jetës politike, ekonomike, social-kulturore e sportive të aktualitetit në vendin tonë.

3. Veprimtaria e RTSH-së gjatë vitit 2017 rezulton në progres drejt synimit për një media në shërbim të publikut, me një sërë aktivitetesh dhe shërbimesh të kryera në transmetime audiovizive dhe audio (TV dhe Radio) gjatë vitit 2017 për herë të parë në historinë e RTSH-së.

4. Realizimi i programeve cilësore radio dhe televizive për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare, të cilave u është dedikuar një program i veçantë me mbulim kombëtar.

5. Sot, RTSH-ja ofron 10 kanale falas, nga ku 3 janë gjeneraliste dhe 7 tematike, 4 radio lokale, 4 kombëtare, Radio Tirana International me 24 orë transmetime në gjuhë të huaja, si dhe shqiptarët jashtë vendit mund të shohin në satelit 6 kanale dhe 4 radio.

6. RTSH-ja ka rritur arkëtueshmërinë e të ardhurave me 10 % nga reklamat, si dhe ka lidhur 47 kontrata për publicitete, njoftime apo sponsorizime programesh të ndryshme.

7. Gjithashtu, të ardhurat e RTSH-së paraqiten 11 % më të larta se të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2016 dhe 5 % më të larta se të ardhurat e vitit 2015 pikërisht nga rritja e financimit buxhetor, i cili për vitin 2017 ka qenë më i madhi financim për RTSH-në nga buxheti i shtetit.

8. RTSH-ja ka kryer ristrukturim të plotë organizativ, duke krijuar njësitë e reja, si dhe ka hartuar rregulloret e veprimtarisë së tyre.

9. Koordinimi me AMA-n ka qenë i vazhdueshëm për implementimin e procesit të digjitalizimit, si dhe për përmbushjen e objektivave, sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratën e shërbimit me AMA-n.

10. Zbatimi i rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian rezulton i kënaqshëm, pasi procesi i digjitalizimit ka ecur me ritme të larta dhe po ashtu dhe funksionaliteti institucional e ligjor i RTSH-së.

11. Për herë të parë raporti i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare 2017 ka shprehur vlerësimin për RTSH-në si i paanshëm e i balancuar, si gjatë pasqyrimit të fushatës elektorale të subjekteve politike, ashtu edhe në ditën e zgjedhjeve.

Për vitin 2018, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Këshilli Drejtues dhe RTSH-ja të përmbushin këto detyrime:

1. Mbulimin me sinjal televiziv të popullsisë sipas parashikimit kontraktues.

2. Të synojë konkurrencë reale mediatike dhe shtimin e të ardhurave nga mënyra e organizimit, prodhimit të programeve dhe shitja e tyre; tërheqjen e sa më shumë reklamave, njoftimeve, arkëtimin e debitorëve; rezultate konkrete lidhur me të ardhurat që rrjedhin nga shfrytëzimi i sistemit

të digjitalizimit; investimet e duhura që synojnë përmirësimin e cilësisë së programeve dhe miratimin e një plan-biznesi, që të mundësojë një administrim më efektiv të RTSH-së.

3. Përdorimin e të ardhurave kryesisht në procesin e investimit në teknologji dhe mbulimit me sinjal të programacionit kombëtar të RTSH-së.

4. Koordinim të ngushtë me AMA-n dhe operatorët e tjerë privatë lokalë, duke përfunduar të gjithë procesin e digjitalizimit.

5. Rezultate konkrete të matshme në rritjen e cilësisë dhe të ofertës televizive, përmes vijimit të ofrimit të programeve dhe shërbimeve të synuara nga RTSH-ja përmes një qasjeje pluraliste, të padiferencuar dhe informim të plotë e të paanshëm.

6. RTSH-ja të zhvillojë programacion të dedikuar edukimit ligjor dhe proceseve integruese të vendit, në kuadër të çeljes së negociatave me BE-në.

7. KDRTSH-ja të zhvillojë transparencën institucionale bazuar në detyrimet e statutit, duke pasuruar faqen zyrtare të internetit me botime periodike dhe testime mbi veprimtarinë e RTSH-së, si dhe të krijojë këndin e vendimmarrjeve të rëndësishme të Këshillit Drejtues.

8. Vitin e ardhshëm RTSH-ja të pasqyrojë një raport të dedikuar për aktivitetin e Këshillit për shikuesit dhe dëgjuesit, lidhur me vëzhgimet dhe gjetjet në lidhje me ndjekjen e shërbimeve të transmetimeve nga ana të miturve dhe të rinjve, të moshuarve dhe kategorive të tjera të veçanta të shoqërisë.

9. Për vitin 2018, Kuvendi i kërkon RTSH-së të hartojë një plan veprimesh për zbatimin e strategjisë dhe detyrimet kontraktuese për kalimin në transmetimet numerike, të kërkuara edhe në kuadër të procesit të integrimit dhe mënyrën e menaxhimit të risive teknologjike.

10. Kuvendi i Shqipërisë dhe Qeveria të kenë në fokus monitorimin e zhvillimit të RTSH-së dhe të sigurojnë mbështetjen e duhur financiare gjatë procesit të rinovimit teknologjik të RTSH-së.

Miratuar në datën 5.7.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke njohur faktin që në tregun e komunikimeve elektronike operatori më i ri i telefonisë së lëvizshme doli nga tregu, dalje e cila u shoqërua me mbylljen e aktivitetit të ofrimit të shërbimeve celulare nga *Plus Communication,* më 31.12.2017 dhe transferimin e të drejtave të përdorimit të radiofrekuancave;

- Duke vlerësuar rolin e AKEP-it në nxitjen e teknologjive të reja, të cilat sjellin rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë, shërbimeve më të mira dhe më eficiente;

- Duke vlerësuar rolin e AKEP-it në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përmirësimit të mbrojtjes së interesave të përdoruesve;

- Duke konsideruar strategjinë *broadband* si tepër të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve të reja në fushën e komunikimeve elektronike.

Për vitin 2017:

- Konstaton një rënie të ndjeshme e të ardhurave nga komunikimet elektronike, si dhe një rënie të ndjeshme të investimeve, ndikuar edhe nga dizinvestimet e *Plus*-it (shitja e aseteve).

- Konstaton një rritje të ndjeshme të përdorimit të shërbimeve të aksesit *broadband* dhe rënie të përdorimit të shërbimeve tradicionale të thirrjeve dhe SMS-ve nga rrjete celulare.

- Vlerëson efektin e masave rregullatore të AKEP-it lidhur me mosdiskriminimin e thirrjeve *on-net/off-net*, gjë e cila ka sjellë një rritje të ndjeshme të trafikut hyrës kombëtar në rrjetet celulare.

Vlerëson rritjen me 10 % në krahasim me vitin 2016 të të ardhurave dhe investimeve në tregun postar.

- Vlerëson përfundimin nga AKEP-i të procesit të "Analizës së tregut celular" që ishte nxjerrë në këshillim publik në dhjetor 2016 dhe kryerjen e procesit të analizës së tregut të telefonisë fikse.

- Vlerëson iniciativat konkrete të AKEP-it në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve, lidhur me portimin e numrave të pajtimtarëve dhe kthimit të paketave 30-ditore.

- Vlerëson punën e bërë nga AKEP-i dhe rolin e tij proaktiv për të mundësuar dhënien e brezit 800 MHz (790-862 MHz) në përdorim të operatorëve celularë për ofrimin e shërbimeve LTE ose, siç njihen ndryshe, si shërbimet 5G, në momentin që ky brez të kalojë në administrim të AKEP-it.

- Vlerëson punën e bërë nga AKEP-i për stabilizimin dhe standardizimin e rrjeteve kabllore të komunikimeve elektronike në qytetet dhe rrugët kryesore të vendit.

- Vlerëson bashkëpunimin e AKEP-it me AMA-n për marrjen e masave ndaj subjekteve *broadcast* që shkaktojnë interferencë, si dhe koordinimin me veprime të përbashkëta me *Albcontrol* për mbajtjen në kontroll të brezit të frekuencave, të cilat përdoren për shërbime radionavigimi.

- Vlerëson bashkëpunimin e AKEP-it me ministrinë përgjegjëse, në kuadër të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

Rekomandon për vitin 2018:

- Në kushtet e daljes së një operatori nga tregu, AKEP-i të bëjë një vlerësim të situatës së re në tregun celular nëpërmjet proceseve të Analizave të Tregut, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë marrjes së masave rregullatore që stimulojnë një konkurrencë efektive, si dhe përfitime të qëndrueshme të përdoruesve në periudhë afatmesme – afatgjatë, përmes një konkurrence të ndershme në treg ndërmjet operatorëve celularë.

- Të punojë për konsolidimin dhe reduktimin e rregulloreve ekzistuese për t'i bërë ato më të thjeshta dhe më të kuptueshme për të gjithë aktorët në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare.

- Të punojë për implementimin e strukturës së re, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 56/2018, me synimin që rritja e kapaciteteve të sjellë një përmirësim të efikasitetit të veprimtarisë së punës së institucionit, rritje të profesionalizmit dhe ekspertizës, si dhe një bashkërendim dhe koordinimin më të mirë për t'u përballur me sfidat e reja që burojnë nga objektivat strategjikë të institucionit në arritjen e standardeve evropiane.

- Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të miratuara lidhur me portabilitetin e numrave të pajtimtarëve, të ndjekë me rigorozitet zbatueshmërinë e këtyre ndryshimeve nga ana e operatorëve, veçanërisht për sa i takon respektimit të përdorimin të Numrit Personal të Identifikimit, si kriteri kryesor për identifikimin e pajtimtarit dhe heqjen e kriterit të refuzimit për shkak të mospërputhjes së emrit/mbiemrit të pajtimtarit, si dhe respektimin e kohës së aktivizimit të numrit të portuar, e cila nuk duhet të jetë me gjatë se një ditë pune nga koha e kërkesës për portim.

- Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, AKEP-i në bashkëpunim edhe me Autoritetin e Konkurrencës dhe me Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit të vijojë procesin e nisur dhe mbrojtjen e qëndrimit zyrtar të tij për rikthimin e kohëzgjatjes mujore (30-ditore) të paketave të ofruara nga operatorët.

- Të marrë masa për garantimin e Shërbimit Universal Postar dhe cilësisë së shërbimeve postare në të gjithë territorin e vendit.

- Të marrë masa për identifikimin e qartë dhe në kohë të sjelljeve strategjike të operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse dhe veçanërisht për çmimet pajustifikueshmërisht të ulëta.

- Të bëjë një analizë të plotë të shkaqeve që çuan në daljen nga një treg i rregulluar i një operatori, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë edhe vendimmarrjes së rregullatorit në vite.

- Me gjithë tejkalimin e afatit të parashikuar (30.6.2017) për kalimin e administrimit të brezit 800 MHz (790-862 MHz) nga AMA tek AKEP-i, të marrë masat e nevojshme që në momentin e lirimit të tij të ketë gati rishikimin e planit kombëtar *broadband* me objektiva dhe synime të qarta për futjen e shërbimeve të lëvizshme në këtë brez.

- Të intensifikojë punën në përmbushjen e plotë të detyrimeve ligjore dhe rregullatore nga ana e sipërmarrësve, në mënyrë që të garantojnë sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të intensifikojë veprimet për zbatimin e plotë të kushteve teknike për ndërtimin e rrjeteve dhe infrastrukturës mbështetëse të tyre, sipas rregullores nr. 22, datë 24.6.2011, "Mbi kushtet teknike për ndërtimin e

infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane" të AKEP-it, si në projektim ashtu edhe në zbatim.

- Të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të hartuar ndryshimet e nevojshme në ligjin për komunikimin elektronik, në përputhje me *acquis*.

- Të mbikëqyrë operatorët dhe të ndjekë tarifat e vendosura nga pushteti vendor për të bërë të mundur një harmonizim të tyre.

- Të luajë një rol nxitës në depërtimin e internetit përmes rrjetit fiks, i cili mbetet në nivele të ulëta, si dhe në zvogëlimin e hendekut të madh që ekziston midis zonave urbane dhe rurale për sa i takon lidhjes në internet.

- Të bashkëpunojë dhe të mbështesë veprimtaritë e Qeverisë për *roaming* zero me vendet fqinje dhe Republikën e Kosovës, si dhe ulje të ndjeshme të tarifave *roaming* me vendet e Bashkimit Evropian.

- Të mbajë në vëmendje të vazhdueshme mbrojtjen e përdoruesve me të ardhura shumë të ulëta.

- Të rrisë përpjekjet për arritjen objektivave *broadband* (30 mbit/sec për 100 % të popullsisë dhe 100 mbit/sec për 50% të popullsisë).

- Me përfundimin e analizës së tregut të telefonisë celulare, të marrë vendimet përkatëse, me transparencë e paanësi për të garantuar mbrojtjen e interesave të përdoruesve, si dhe operimin në një treg konkurrent dhe jodiskriminues.

- Të punojë për zbatimin e strategjisë *broadband*, duke zbatuar detyrimin ligjor në përgatitjen e akteve nënligjore, në zbatim te ligjit nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit", duke iu referuar rekomandimeve të ITU-së, BEREC-ut etj. në këtë strategji.

- Të kryejë rregullimin e nivelit të tarifave të terminimit/transitimit në rrjetet publike të telefonisë fikse, duke u bazuar në zhvillimet e ndodhura dhe pritshmëritë e operatorëve, si dhe në përvojat ndërkombëtare për këtë çështje, duke e përshtatur me kushtet e tregut shqiptar për telefoninë fikse, që karakterizohet nga një penetrim dhe përdorim shumë më i ulët në krahasim me vendet e BE-së dhe të rajonit.

Miratuar në datën 5.7.2018.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

VENDIM
Nr. 409, datë 4.7.2018

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, NGA FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT NË AGJENCINË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2018 bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në programin buxhetor 06220 "Infrastruktura vendore dhe rajonale", artikulli 231, zëri "Shpenzime kapitale", i pakësohet fondi prej 2 879 800 (dy milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekësh;

b) Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në programin buxhetor 01160 "Prefekturat dhe funksionet e deleguara të pushtetit vendor", artikulli 231, zëri "Shpenzime kapitale", i shtohet fondi i përmendur në shkronjën "a", të kësaj pike, për financimin e projektit në vazhdim "Sistemi i menaxhimit të arkivit dhe protokollit në njësitë e qeverisjes vendore dhe infrastruktura për digjitalizimin e dokumenteve të këtyre njësive", të Shqipërisë digjitale.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 410, datë 4.7.2018

PËR CAKTIMIN E MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË SI ORGANIN E INTERESUAR DHE AUTORIZIMIN E SAJ PËR TË LIDHUR SHTESË KONTRATE, NËPËRMJET AVOKATURËS SË SHTETIT, ME FIRMËN AVOKATORE "GOWLING WLG", PËR PËRFAQËSIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR SHOQËRISË "HYDRO S.R.L.", ICC 22919/GR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 7; 5, pika 1, shkronja "b"; 12, pikat 2 e 6; 15, pika 8, dhe 18, pika 2, të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si organin e administratës publike të interesuar në çështjen e arbitrazhit kundër shoqërisë "Hydro S.R.L.".

2. Autorizimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, të lidhë shtesë kontrate me firmën avokatore ndërkombëtare "Gowling WLG" për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar të iniciuar nga shoqëria "Hydro S.R.L.", ICC 22919/GR, të negociuar nga Avokatura e Shtetit, me vlerë të përgjithshme 950 000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) euro.

3. Shtesa e kontratës të rregullojë përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar kundër shoqërisë "Hydro S.R.L."

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 412, datë 4.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM, ASFALTIM I SHESHIT MIDIS PALLATEVE NË LAGJEN 'SKËNDER LIBOHOVA', LUSHNJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1; 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Sistemim, asfaltim i sheshit midis pallateve në lagjen 'Skënder Libohova', Lushnjë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me vlerë të përgjithshme 358 160 (treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 358 160 (treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohet për efekt shpronësimi

pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "SISTEMIM, ASFALTIM MIDIS PALLATEVE NË LAGJEN 'SKËNDER LIBOHOVA'", LUSHNJË
INVESTITORI: BASHKIA LUSHNJË

Çmimi për pasurinë truall, sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Pali Trifon Syziu	8572	6/136	Truall	m²	40	8954	358,160	Me shkresën nr. 3376/1, datë 24.4.2017
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMIT:								**358,160**	

VENDIM
Nr. 413, datë 4.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV", FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV", Fier.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën totale prej 1 454 376 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 454 376 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, përmendur në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues

për likuidim, pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të OSHEE sh.a.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes se gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV", FIER
INVESTITORI: OSHEE SHA
Çmimi për pasurinë truall, sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	N. i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Marine Tiko Mino, Harilla Mihal Mino, Arqile Mihal Mino, Valentina Mihal Goxhaj, Drita Mihal Troka, Loreta Mihal Lamaj	3981	75/28	Arë	m²	894.1	269	240,513	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Shtet	3981	75/29	Arë	m²	428.9			Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Drita Mihal Mino	3981	75/4	Arë	m²	818.4	269	220,150	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, pa certifikatë pronësie
4	Harilla Mihal Mino	3981	75/5	Arë	m²	1989.4	269	535,149	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, pa certifikatë pronësie
5	Naun Thoma Devija , Lida Shaqir Devija, Aleksandër Naun Devija, Jurgen Naun Devija	3981	75/46	Arë	m²	1704.7	269	458,564	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMIT:								**1,454,376**	

VENDIM
Nr. 414, datë 4.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV", VELIPOJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1; 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i nënstacionit të ri 110/20 kV", Velipojë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë,

sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën totale prej 972 000 (nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 972 000 (nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekësh, të përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.

6. Shpronësimi të fillojë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të përmendur në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të OSHEE sh.a.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes se gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I NËNSTACIONIT NË VELIPOJË 110/20 kV"
INVESTITORI: OSHEE SHA

Çmimi për pasurinë truall, sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	N. i pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	Gjekë Kolë Preka	3072	1097/87	Arë	m²	2276.6	270	614,682	Me shkresën nr. 5267/1, datë 28.8.2017
2	Pjetër Kolë Preka	3072	1097/100	Arë	m²	1323.4	270	357,318	Me shkresën nr. 5267/1, datë 28.8.2017, kartela e pasurisë ka shënimin "Urdhër kufizimi", referuar rekomandimeve të KLSH-së
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMIT:								**972,000**	

VENDIM
Nr. 415, datë 4.7.2018

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 8.12.2016, PËR ÇËSHTJEN "MOLLA KUNDËR SHQIPËRISË" (KËRKESA NR. 29680/07)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.12.2016, për çështjen "Molla kundër Shqipërisë" (kërkesa nr. 29680/07).

2. Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së, të bëhet ekzekutimi me mjete të përshtatshme i vendimit nr. 00-2008-33, datë 11.1.2008, të

Gjykatës së Lartë, të dhënë në favor të ankueses, znj. Frida Molla, për lënien në fuqi të vendimit nr. 173, datë 27.6.2006, të Gjykatës së Apelit Korçë, e cila ka vendosur detyrimin e Ndërmarrjes Zonale të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Korçë për të ndaluar punimet në pronën e paditëses Frida Molla, si dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme.

3. Ekzekutimi i vendimit të GJEDNJ-së, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të bëhet nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Korçë.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria Rajonale e OSHEE sh.a., Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 416, datë 4.7.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 443, DATË 16.6.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN, REGJISTRIMIN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË ADMINISTRIMIT E TË NDËRVEPRIMIT DHE PËR SIGURINË E SISTEMIT TË MENAXHIMIT ELEKTRONIK TË ÇËSHTJEVE TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR (ALBIS)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 516/a, të Kodit të Procedurës Civile, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", të nenit 26, të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor", dhe të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 443, datë 16.6.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Titulli i vendimit ndryshon dhe bëhet: "Për përcaktimin e mënyrës së funksionimit, të administrimit dhe të ndërveprimit të Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor (ALBIS), si regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit".

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Objekt i këtij vendimi është krijimi i bazës së të dhënave "Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor" (ALBIS), që shërben edhe si regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të titujve ekzekutivë, sipas nenit 516/a, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe përcaktimi i përmbajtjes së informacionit, parimeve dhe rregullave për funksionimin e këtij sistemi.".

3. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 deri në 1/6, me këtë përmbajtje:

"1/1. Regjistri qendror i kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit mbahet vetëm në format elektronik. Formati elektronik konsiderohet baza e të dhënave të Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor (ALBIS).

1/2. Parimi bazë i funksionimit të sistemit ALBIS është përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave/informacionit të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale.

1/3. Të drejtat për aksesin dhe përpunimin e të dhënave në sistemin ALBIS, sipas rolit të përdoruesit, duhet të jenë të autorizuara, si më poshtë vijon:

- për Ministrinë e Drejtësisë, me autorizim me shkrim të ministrit të Drejtësisë;

- për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, me autorizim me shkrim të drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit;

- për përmbaruesit gjyqësorë privatë, me autorizim me shkrim të kryetarit të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

1/4. Ministria e Drejtësisë nuk mban përgjegjësi për mënyrën e përdorimit të informacionit të raportuar në sistemin ALBIS, kur ky i fundit është i pasaktë ose i paplotë, si rrjedhojë e raportimit të pasaktë e të paplotë, dhe/ose për gabime në përpunimin e informacionit nga përdoruesit e saj të autorizuar.

1/5. Lëshimi i vërtetimeve për gjendjen për ekzekutim të një titulli ekzekutiv pranë përmbarimit gjyqësor lëshohet, përkatësisht, nga Drejtoria e

Përgjithshme e Përmbarimit, për përmbarimin gjyqësor shtetëror, dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, për përmbaruesit gjyqësorë privatë. Vërtetimi lëshohet pas paraqitjes së kërkesës, shoqëruar me kopje të mjetit të identifikimit. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë evidentojnë në një regjistër të posaçëm të gjitha kërkesat e këtij lloji. Formati i regjistrit, formati i vërtetimit, procedura dhe kërkesat për lëshimin e tij detajohen prej tyre dhe miratohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

1/6. Baza e të dhënave ALBIS përmban:

a) Të dhënat e regjistrave të çështjeve përmbarimore aktive dhe/ose të pezulluara, të regjistruara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe të çështjeve përmbarimore të reja, që paraqiten për ekzekutim pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

b) Të dhënat e regjistrave të çështjeve përmbarimore të pushuara, të arkivuara ose të transferuara, të regjistruara nga përmbaruesit gjyqësorë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) Të dhënat e regjistruara në sistem nga përmbaruesit gjyqësorë, sipas numrit të protokollit të librit të përmbaruesit gjyqësorë ose zyrës/shoqërisë përmbarimore për dokumentet procedurale, vendimet, urdhrat e ekzekutimit apo të dhënave që lidhen me çështjen dhe palët në procesin e ekzekutimit;

ç) Elemente të sigurisë;

d) Informacion për procesin ekzekutues të çështjes përmbarimore të përmbaruesit, i cili paraqitet kur kërkohet nga strukturat që kanë të drejtën e aksesit në sistem;

dh) Materiale për instruktim, në ndihmë për përdoruesin e sistemit;

e) Ndërfaqe të bazuar në teknologjinë portal;

ë) Funksione kërkimi;

f) Raportim të statistikave dhe analizave (në dimensione të ndryshme dhe në kohë reale).".

4. Përmbajtja e anekseve nr. 1 dhe nr. 2 ndryshohet sipas anekseve përkatëse nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Pika 3 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"3. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore e të dhëna dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura në kohë reale dhe që kanë të bëjnë me:

i. të dhëna për çështjet përmbarimore dhe përshkrime për ekzekutimin e tyre;

ii. fazën procedurale të procesit përmbarimor, referuar dokumenteve të përmbaruesit gjyqësor gjatë veprimtarisë së tij, të regjistruara në sistem sipas aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat e siguruara nga ndërveprimi me baza të tjera të të dhënave shtetërore dhe kanë të bëjnë me:

i. palët;

ii. të tretët;

iii. të dhëna të vendimeve gjyqësore;

iv. ndërveprimin me institucionet e tjera.".

6. Shkronja "c", e pikës 5, shfuqizohet.

7. Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë dhe privatë, brenda 9 muajve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të kenë përfunduar hedhjen e të dhënave në sistem për të gjitha çështjet përmbarimore që kanë në administrim, sipas shkronjave "a" e "b", të pikës 1/6, të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për zbatimin e këtij vendimi dhe orientimin e përmbaruesve gjyqësorë shtetërore e privatë në përmbushjen e detyrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKS 1
KOMPONENTËT E ARKITEKTURËS
SOFTWARE DHE *HARDWARE* TË ALBIS-it

Përshkrim teknik i ALBIS-it

Arkitektura teknike dhe funksionale e "Sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit gjyqësor" është e orientuar 100% kundrejt shërbimeve *(SOA-Service Oriented Architecture)* dhe mundëson menaxhimin me sukses të çështjeve, dokumenteve dhe proceseve të punës së përmbarimit shtetëror dhe atij privat.

Arkitektura funksionale

Arkitektura funksionale e Sistemit është dizenjuar në mënyrë që të plotësojë maksimalisht të gjitha nevojat për menaxhimin e çështjeve të shërbimit të përmbarimit gjyqësor shtetëror dhe privat, si nga ana operative, gjithashtu, dhe nga ajo organizative. Për sa i përket anës operative, ajo u siguron përmbaruesve gjyqësorë, shtetërorë dhe privatë, një sistem fleksibël me një shkallë të lartë automatizimi, duke i dhënë mundësinë e rritjes së eficiencës së tyre në maksimum. Eficienca e lartë do të sigurojë si përfundim rritjen e cilësisë së shërbimit të përmbarimit gjyqësor ndaj qytetarëve shqiptarë. Për sa i përket anës organizative, arkitektura funksionale nëpërmjet raporteve, analizave, dhe statistikave u jep mundësinë organeve përkatëse të kenë në kohë reale dhe në mënyrë të saktë të gjithë informacionin e duhur për të kontrolluar dhe për të përmirësuar strukturën dhe funksionimin e këtij shërbimi.



Elementet themelore të arkitekturës funksionale janë: çështjet, dokumentet dhe palët. Këto elemente janë të ndërlidhura midis tyre dhe çdo element apo objekt tjetër në sistem është i lidhur me këto:



Sistemi i menaxhimit elektronik të çështjeve i ndërtuar në bazë të kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë përbën një sistem të plotë dhe të avancuar duke plotësuar tërësisht kërkesat e shkallëzuara dhe të sofistikuara të shërbimit përmbarimor gjyqësor. Karakteristikat ose funksionet e tij kryesore mund të përmblidhen si më poshtë:

- Menaxhimi i çështjeve:
- regjistrimi i çështjeve;
- shpërndarja e çështjeve;
- monitorimi dhe ndjekja e çështjeve;
- alarme për çështjet.

- Menaxhimi i dokumenteve:
- regjistrimi i dokumenteve;
- integrimi me *Microsoft Office*;
- prodhimi i dokumenteve të çështjeve;
- kategorizimi i dokumenteve;
- integrimi me *Windows Explorer*.

- Menaxhimi i kontakteve:
- regjistri i kontakteve;
- struktura e dosjeve;
- historiku i komunikimi.

- Siguria:
- siguri në nivel objekti apo dokumenti;
- klasifikim i sigurisë.

- Rrjedha pune të strukturuara dhe të veçanta:
- automatizim i proceseve;
- rishikim i cikleve të çështjeve;
- menaxhim i rregullave.

- Instruktimi dhe ndihma:
- ndihmë dhe instruktim proaktiv i përdoruesit;
- ndihmë në përputhje me kontekstin.

- Ndërfaqe e bazuar në teknologjinë portal:
- vetëshërbim;
- ndërfaqe e bazuar sipas roleve.

- Navigim/kërkim

- Raportim:
- statistika dhe analiza në dimensione të ndryshme;
- statistika dhe analiza në kohë reale;
- fleksibilitet në krijimin e raporteve.

Arkitektura teknike

Arkitektura teknike e sistemit AlBIS është e bazuar në teknologjitë më të avancuara *hardware* dhe *software*, të cilat janë të testuara dhe sigurojnë një menaxhim dhe kontroll të plotë të proceseve dhe dokumenteve të sistemit të përmbarimit. Sistemi përmban opsionin përkatës që përmbaruesit gjyqësorë privatë të mund të logojnë vetëm përmes sistemit SIAIP, që përdoret prej tyre, në sistemin ALBIS. Ky opsion bën të mundur që përmbaruesit privatë të mos logohen dy herë, por mjafton të jenë të loguar 1 herë në SIAIP dhe me të njëjtat kredenciale, nëse duan, vijojnë punën në sistemin ALBIS.

Arkitektura *software*

Arkitektura *software* e AlBIS-it është e bazuar në platformën e IBM FileNet P8, e cila në bashkëpunim me komponentët e tjerë mundëson menaxhimin e çështjeve dhe të dokumenteve, në mënyrë të pajtueshme me të gjitha llojet e rregullave institucionale apo ligjore të shërbimit përmbarimor shtetëror apo privat. Gjithashtu, ajo bën të mundur kontrollin dhe menaxhimin nga Ministria e Drejtësisë, e të gjitha proceseve, informacionit dhe sigurisë.



Hierarkia e përdoruesve

Sistemi do të ketë këto role përdoruesish:

- **Administratori** do të ketë të drejtat e administrimit të sistemit.

- **Specialistët me detyra monitoruese** të Ministrisë së Drejtësisë ose të DPP-së do të kenë të drejta leximi në ato çështje që ata do të kontrollojnë.

- **Drejtori i përgjithshëm i DPP-së dhe drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë** do të ketë të drejta leximi te të gjitha çështjet e përmbarimit shtetëror.

- **Drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë** do të ketë të drejta leximi te të gjitha çështjet e përmbarimit privat.

- **Kryetari i Zyrës Rajonale** do të ketë të drejta të regjistrojë një çështje në sistem, të hedhë shortin, të zëvendësojë përmbaruesin (e zyrës përkatëse), të transferojë çështjen në një zyrë tjetër. Do të ketë të drejta leximi në të gjitha çështjet e zyrës së tij. Gjithashtu, do të ketë të njëjtat të drejta me një përmbarues kur ai/ajo është përgjegjës për çështjen.

- **Përmbaruesi shtetëror** do të ketë të gjitha të drejtat e nevojshme për përpunimin e çështjeve që i janë përcaktuar. Do të ketë mundësi të shikojë vetëm çështjet që i takojnë.

- **Përmbaruesi privat** do të ketë të gjitha të drejtat e nevojshme për regjistrimin dhe procesimin e çështjeve që ai ka marrë përsipër.



Arkitektura *hardware* (*Data-Center* në Ministrinë e Drejtësisë)

Arkitektura teknike *hardware* e AlBIS-it është një arkitekturë e dizenjuar duke përdorur pajisje të teknologjisë së fundit që bëjnë të mundur funksionimin me performacë maksimale të sistemit.

Pajisjet e njësisë qendrore *(Data Center)* përshijnë infrastrukturën e mëposhtme:

1. Fujitsu PY BX900 S1 System Unit me 8 server-a: PY BX920 S2 Dual Server Blade;
2. Firewall Cisco ASA5510-AIP10-K9;
3. UPS e instaluar në një Rack Fujitsu;
4. 46 HU Fujitsu Primergy Primecenter Rack.



ANEKS 2
MODELI I PARAQITJES SË TË DHËNAVE TË SISTEMIT ALBIS

1. Të dhëna parësore

ALBIS-i regjistron këto të dhëna parësore:

Fushat	Përshkrimi
Nr. i çështjes	Nr. i çështjes/i dosjes përmbarimore që regjistrohet. Vendoset nga ALBIS.
Nr. i vjetër i çështjeve	Numri i vjetër i çështjeve të regjistruara. Do të përdoret për çështjet aktive të cilat janë hapur përpara kalimit *online* të sistemit.
Zyra e përmbarimit/ përmbaruesi privat	Zyra e përmbarimit shtetëror ose përmbaruesi privat: vendoset nga ALBIS profili i përdoruesit.
Nr. i protokollit	Numri i protokollit me të cilin është regjistruar kërkesa për hapjen e çështjes përmbarimore në zyrën shtetërore.
Data/nr. i prot. të kërkesës	Data e regjistrimit të kërkesës për vënie në ekzekutim të kreditorit nga përmbaruesi gjyqësor privat ose shoqëria përmbarimore/nr. prot.
Nr./datë e urdhrit ekzekutiv/vendimit	Numër/datë e urdhrit të ekzekutimit ose numër/datë e vendimit të gjykatës kur nuk ka urdhër ekzekutimi të veçantë.
Gjykata	Gjykata që ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit/vendimin.
Titulli ekzekutiv	Lloji i titullit ekzekutiv (numër, datë, të dhëna, origjinal apo i noterizuar)
Objekti	Përshkrimi i shkurtër i objektit të ekzekutimit.
Data e regjistrimit	Data e regjistrimit të çështjes (dd.mm.vvvv).
Statusi i çështjes:	Vendoset statusi i çështjes (aktiv, pezulluar, pushuar).
Transferimet e çështjeve përmbarimore	Vendoset nr. datë vendimi, autorizimi për transferimin e çështjes përmbarimore (emri i transferuesit dhe i marrësit).
Data e fillimit të ekzekutimit	Data në të cilën përmbaruesi fillon ekzekutimin e çështjes (dokumenti i parë procedural i përmbaruesit, nr. /datë).
Kreditori	Kreditori, bashkëkreditorët, përfaqësuesit ligjorë.
Debitori	Debitor, debitorët, dorëzanësit, hipotekuesit, palët e lidhura.
Lloji i detyrimit (monetar ose jomonetar)	Vendoset shuma e detyrimit të debitorit ose lloji i detyrimit jomonetar.
Lloji i taksës Lloji i tarifës	Vendoset lloji i taksës përmbarimore: E vlerësueshme (%) ose e pavlerësueshme (3.800) dhe lloji i tarifës.
Komunikimi	Jepen të dhëna në lidhje me komunikimin ndërinstitucional shkresor të çdo çështjeje përmbarimore.
Informacion mbi procesin ekzekutues nga përmbaruesi gjyqësor	Jepet një informacion i kërkuar nga ministri i Drejtësisë apo struktura e autorizuar prej tij në lidhje me procesin ekzekutues të çështjes përmbarimore.
Komente	Mund të shkruhen komente nga më të ndryshmet.

2. Të dhëna dytësore

ALBIS-i regjistron këto të dhëna dytësore:

Person juridik (kompanitë/institucionet)	**Regjistri Tregtar i QKB-së**
Emri	Emërtimi i kompanisë apo i institucionit
E-mail	Adresa e postës elektronike
Numrat e telefonit	Vendosen numrat e telefonit. Mund të shtohen sipas nevojës
Adresa	Vendoset adresa e personit juridik
Kodi postar	Vendoset kodi postar
Qyteti	Qyteti *(list)*
Shteti	Shteti
NIPT	NIPT-i i kompanisë
Lloji i palës	Përzgjidhet nga lista lloji i kompanisë apo i institucionit
Person fizik (individ)	**Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile**
Emri	Vendoset emri i plotë i individit së bashku me atësinë
E-mail	Adresa e postës elektronike
Numrat e telefonit	Vendosen numrat e telefonit. Mund të shtohen sipas nevojës
Adresa	Vendoset adresa e personit
Kodi postar	Kodi postar
Qyteti	Qyteti
Shteti	Shteti
ID	Vendoset numri personal i kartës së identitetit
Të dhëna automjeti	**Regjistri Kombëtar i Mjeteve**
Targa e mjetit	Vendoset targa e mjetit të debitorit
Nr. i shasisë	Numri i shasisë së mjetit
Të dhëna të mjetit (lloji, marka, modeli, tipi, karroceria, ngjyra, nr. i dyerve, lënda djegëse, fuqia, cilindrata, viti i prodhimit, nr. i vendeve)	Të dhëna të skedës teknike të mjetit
Lloji i përdorimit	Lloji i përdorimit
Pronari i mjetit (ID, emër mbiemër, adresa)	Të dhëna të pronarit (debitorit)
Të dhëna të pasurive të paluajtshme	**Regjistri Elektronik i Pasurive të Paluajtshme**
Nr. i pasurisë	Vendoset nr. i pasurisë
Zona kadastrale	Vendoset nr. i zonës kadastrale
Volum, faqe	Të dhëna të volumit dhe të faqes të shënuara në kartelë
Lloji i pasurisë	Lloji i pasurisë
Të dhëna të pronarëve (ID, emër mbiemër, adresa)	Të dhëna të pronarit/pronarëve të pasurisë
Gjendja juridike e pasurisë	Vendoset gjendja juridike e pasurisë

VENDIM
Nr. 418, datë 4.7.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 788, DATË 22.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, STANDARDEVE DHE PROCEDURAVE TË PROCESIT TË AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 33/1, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 788, datë 22.9.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pika 1.1.1 riformulohet me këtë përmbajtje:

"1.1.1 Aplikimi për akreditimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim, për profesionistët e shëndetësisë duhet të bëhet në Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, këtu e më poshtë QKEV, nga ofruesi/t e aktivitetit, jo më vonë se 30 ditë nga data e planifikuar për zbatimin e tij. Aplikimi për akreditim shoqërohet me pagesën e një tarife, që varion sipas llojit dhe kohëzgjatjes së aktivitetit, e cila miratohet nga Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm, këtu e më poshtë BEV.".

2. Pas pikës 1.5.3.7 shtohet pika 1.5.3.8, si më poshtë vijon:

"1.5.3.8 Mosdeklarim i mbështetjes financiare ose deklarim i rremë në aplikimin për akreditim.".

3. Pas pikës 1.5.4 shtohet pika 1.5.4/1, me këtë përmbajtje:

"1.5.4/1 Në raste shkeljesh të përsëritura për ofrues, të cilët janë pezulluar një herë nga QKEV-ja, BEV-i, me propozimin e QKEV-së, mund të pezullojë ofruesin nga ofrimi i aktiviteteve të akredituara për një periudhë deri në 3-vjeçare.".

4. Në fund të pikës 1.5.5 shtohen fjalët: "... Këtu përjashtohen aktivitetet ku numri i pjesëmarrësve në sallë është më i madh se 200 veta ...".

5. Pas pikës 2.11.5 shtohen pikat 2.11.6, 2.11.7 dhe 2.11.8, si më poshtë vijon:

"2.11.6 Duhet të ketë statusin "ofrues i akredituar" nga QKEV-ja ose nga një institucion tjetër i barasvlershëm në një shtet tjetër të OECD-së. Në rastet kur nuk është i akredituar, ofruesi duhet të ketë një marrëveshje me një ofrues të akredituar nga QKEV-ja ose nga një institucion tjetër i barasvlershëm në një shtet tjetër të OECD-së.

2.11.7 Për aktivitetet *E-Learning*:

a) Ofruesi duhet të sigurojë përdorimin e materialeve didaktike në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritshme, me anë të teknologjive multimediale, nëpërmjet lidhjes me internetin;

b) Ofruesi duhet të përdorë një platformë teknologjike, e cila i dedikohet edukimit dhe garanton përdorimin pa pasur nevojë për orare të caktuara apo të qenit të pranishëm në vende të përcaktuara që më parë;

c) Platforma teknologjike duhet të garantojë përdorimin e lehtë të kurseve, regjistrimin e përdoruesve, mundësinë për dhënien e pëlqimit për privatësinë dhe trajtimin e të dhënave të përdoruesve, verifikimin e veprimeve të kryera nga përdoruesit në platformë dhe të jetë në gjendje të masë nivelin e përvetësimit të kurseve nga përdoruesit nëpërmjet testeve vlerësuese dhe testeve për shkallën e pëlqimit të çdo kursi edukues;

ç) Platforma teknologjike duhet të parashikojë një apo më shumë module të edukimit/të formimit, si dhe procese të ndërmjetme vetëvlerësimi;

d) Verifikimi i pjesëmarrjes duhet të sigurohet me anë të testeve për lëndët e dhëna dhe duhet të garantohet nga kontrolli i veprimeve të kryera nga sistemi. Përveç këtyre, duhet të parashikohen edhe verifikime të veçanta të identitetit të profesionistit.

2.11.8 Për aktivitetet e edukimit në distancë, sinkron (të njëkohshëm), pjesëmarrja në leksione ose sesione edukuese, që zhvillohen larg vendit ku është profesionisti, duhet të arrihet nëpërmjet përdorimit të një platforme multimediale të dedikuar (klasa virtuale, *webinar*), nëpërmjet lidhjes me internetin. Pjesëmarrja e njëkohshme duhet të parashikojë lidhjen në internet të pjesëmarrësve në orare të caktuara që më parë nga programi mësimor dhe të garantojë një nivel të lartë ndërveprimi ndërmjet lektorëve/tutorëve dhe pjesëmarrësve. Çdo orë mësimi, përfshirë edhe

ndërhyrjet e pjesëmarrësve, duhet të regjistrohet dhe të jetë e disponueshme për t'u verifikuar, përdorur apo përsëritur në një moment tjetër. Pjesëmarrja individuale në aktivitet duhet të verifikohet me anë të regjistrimit të lidhjeve *online* në platformë gjatë orës së mësimit. Verifikimi i dijeve duhet të bëhet nëpërmjet testit që kryhet në përfundim të sesionit.".

6. Pas pikës 2.16 shtohet pika 2.17, si më poshtë vijon:

"2.17 Ofruesi duhet të sigurojë përkthim për pjesëmarrësit në rastet kur aktiviteti apo një pjesë e tij zhvillohet në gjuhë të huaj.".

7. Pika 3.1.4.3 riformulohet me këtë përmbajtje:

"3.1.4.3 Gjatë aktivitetit të edukimit në vazhdim është i ndaluar çdo lloj materiali për promocion të produkteve apo publicitet i produkteve specifike, që shpërndahet nga ofruesi brenda sallës së zhvillimit të aktivitetit të akreditуar dhe brenda hapësirës edukative. Duhet të shmanget ballafaqimi dhe krahasimi i produkteve apo i subjekteve të ngjashme. Aktivitetet promocionale gjatë aktiviteteve të drejtpërdrejta (prova materiale mbështetëse, prezantim) ose publiciteti në materialet elektronike apo të printuara duhet të jenë të ndara nga aktiviteti i edukimit në vazhdim.".

8. Pika 3.1.4.6 shfuqizohet.

9. Pika 4.7 riformulohet si më poshtë vijon:

"4.7 "Aktivitet kërkimor/studimor", përfshi-rja e profesionistit në punë kërkimore, në shkrime artikujsh apo materialesh të tjera profesionale dhe shkencore është një formë tjetër e edukimit në vazhdim.".

10. Pas pikës 4.7 shtohet pika 4.7/1, me këtë përmbajtje:

"4.7/1 Për aktivitetet e drejtpërdrejta *(live)*,:

a) Kur numri i pjesëmarrësve është deri në 100 veta, përllogaritja e krediteve kryhet sipas kriterit "një kredit për çdo orë". Kur numri i pjesëmarrësve është 101–200 veta, përllogaritja e krediteve kryhet sipas kriterit "0.7 kredite për çdo orë", ndërsa për aktivitete me mbi 200 pjesëmarrës zbatohet kriteri "0.5 kredite për çdo orë";

b) Për trajnime të individualizuara, që përfshijnë fitimin e njohurive dhe të aftësive në kryerjen e procedurave apo të teknikave të reja dhe përdorimin e teknologjive me jo më shumë se 5 pjesëmarrës, përllogaritja e numrit të krediteve bëhet sipas kriterit "1.5 kredite për çdo orë". Përllogaritja bazohet vetëm në kohëzgjatjen efektive, që përfshin orët reale të mësimdhënies dhe të ndërveprimit me pjesëmarrësit, duke mos përfshirë pushimet ndërmjet prezantimeve, seancën prezantuese të aktivitetit etj. Kohëzgjatja e aktivitetit nuk duhet të kalojë 10 orë;

c) Në rastet e aktiviteteve që zhvillohen në salla paralele, përllogaritja e numrit të pjesëmarrësve bëhet veçmas për çdo sallë. Numri maksimal i krediteve, që bazohet në orët efektive, nuk duhet të kalojë 6 kredite në ditë. Ndërsa, mund të bëhet një rritje 0.3 kredite për çdo orë për përmbushjen e secilit prej këtyre kritereve:

i. numri i parashikuar i pjesëmarrësve është deri në 25;

ii. përdorimi i metodologjisë interaktive, për të paktën, 50 pjesëmarrës;

iii. tema e aktivitetit është në përputhje me fushat prioritare të miratuara nga QKEV-ja.".

11. Pika 4.8 riformulohet si më poshtë vijon:

"4.8 Aktivitetet e edukimit në distancë akreditohen sipas kriterit "një kredit për çdo orë" të parashikuar. Për aktivitetet *E-Learning*, në rast se platforma teknologjike përdor hapësira bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve (*chat*, forum) dhe kanale interaktive sinkrone dhe/ose asinkrone (brenda 48 orësh) me lektorët/tutorët, mund të bëhet një rritje 0.5 kredite për çdo orë. Për aktivitetet e edukimit në distancë, sinkron (të njëkohshëm), përllogaritja e krediteve bëhet sipas kriterit "1.5 kredite për çdo orë".".

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 419, datë 4.7.2018

PËR KRIJIMIN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË OPERATORIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (këtu e më poshtë "Operatori"), si person juridik publik në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë (këtu e më poshtë "ministri").

Operatori financohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, sigurimet shëndetësore dhe burime të tjera të ligjshme.

2. Operatori është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve shëndetësore, pjesë integrale të sistemit të ministrisë, që kontribuojnë në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për mirëqenie shëndetësore, si një nga elementet e rëndësishme të mirëqenies së përgjithshme të qytetarit, nëpërmjet mbrojtjes së shëndetit dhe promovimit të jetesës së shëndetshme në mënyrë të organizuar e të barabartë për të gjitha grupet e popullatës.

3. Misioni i Operatorit është ofrimi i shërbimit të kujdesit parësor e spitalor, në përputhje me nevojat, standardet, protokollet dhe kërkesat e përcaktuara, duke garantuar ofrimin e plotë, cilësor e në kohën e duhur të shërbimit, dhe përdorimin në mënyrë eficiente të burimeve njerëzore e financiare, të aseteve dhe materialeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e kujdesit shëndetësor dhe shërbimin spitalor.

4. Operatori e ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit, në këto fusha përgjegjësie:

a) Kujdesi shëndetësor parësor;

b) Shërbimi spitalor në nivel rajonal dhe bashkiak.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË OPERATORIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Operatori ka përgjegjësi:

1. Të organizojë punën për ofrimin e shërbimeve bazë të shëndetit publik dhe të shërbimeve të tjera ndihmëse, sipas paketës së shërbimeve të shëndetit publik.

2. Të organizojë punën për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nëpërmjet veprimtarisë së qendrave/klinikave shëndetësore.

3. Të organizojë punën për ofrimin e shërbimeve me shtretër në spitale rajonale e bashkiake, sipas standardeve dhe protokolleve të miratuara nga ministri.

4. Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndetin publik dhe spitalor, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I OPERATORIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Operatori e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ai organizohet në:

a) Nivel qendror, nëpërmjet Drejtorisë Qendrore;

b) Nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale;

c) Njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, qendrat shëndetësore/klinikat dhe institucionet shëndetësore me shtretër/spitalet.

2. Drejtoritë rajonale krijohen kur mbulojnë jo më pak se 4 000 punonjës. Ministri miraton me urdhër numrin e drejtorive rajonale, shtrirjen territoriale dhe qarkun ku do të ngrihet drejtoria.

3. Drejtoritë rajonale raportojnë te drejtori i Përgjithshëm i Operatorit dhe kanë nën varësinë e tyre njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, qendrat shëndetësore/klinikat dhe institucionet shëndetësore me shtretër/spitalet.

4. Operatori ka lidhje funksionale bashkëpunimi me institucionet e tjera të kujdesit shëndetësor në varësi të ministrit dhe me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH).

5. Operatori drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e operatorit përkatës dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe lirohet nga ministri.

6. Struktura dhe organika e operatorit në nivel qendror dhe e drejtorive rajonale miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Struktura dhe organika e njësive vendore të kujdesit shëndetësor, të qendrave shëndetësore/klinikave dhe institucioneve shëndetësore me shtretër/ spitaleve, miratohet nga ministri.

7. Drejtoria qendrore kryen detyrat si më poshtë vijon:

a) Analizon dhe zbërthen politikat, strategjitë e zhvillimit, programet, kuadrin rregullator në fushën e shëndetësisë, duke u përqendruar në komponentët që lidhen me ofrimin e shërbimit shëndetësor;

b) Vlerëson nevojat dhe problematikat e hasura në praktikë/terren gjatë ofrimit të shërbimit shëndetësor dhe përvetëson ekspertizën e nevojshme prej strukturave në varësi;

c) Harmonizon politikat, strategjitë, financimin, parashikimet dhe rregullat ligjore, që vijnë nga ministria, me nevojat, problematikat dhe ekspertizën që vjen nga poshtë (drejtoritë rajonale dhe ofruesit direkt të shërbimeve, si spitalet dhe qendrat shëndetësore);

ç) Identifikon dhe analizon nevojat publike për shërbim shëndetësor, që rezultojnë nga integrimi i nevojave të paraqitura në studime, analiza, kërkime nga ISHP-ja etj.;

d) Vlerëson gjendjen e shërbimeve shëndetësore dhe cilësinë e tyre, me qëllim analizimin e gjendjes ekzistuese dhe të nivelit ku dëshirohet të arrihet, si dhe çfarë duhet ndryshuar/përmirësuar te shërbimi i ofruar;

dh) Është përgjegjëse për garantimin e burimeve (njerëzore, mallra/materiale, pajisje/teknologji, shërbime), në përputhje me kërkesat e përcjella nga strukturat e varësisë;

e) Vlerëson nevojën për burime e situatën ekzistuese në terren, planifikon volumin e burimeve dhe programon shpërndarjen e tyre.

8. Drejtoritë rajonale kryejnë detyrat si më poshtë vijon:

a) Planifikojnë nevojat për shërbime të kujdesit shëndetësor në nivel rajoni;

b) Garantojnë që shërbimet shëndetësore të ofrohen brenda standardeve, në kohë, brenda buxhetit dhe në cilësinë e kërkuar, në territorin që mbulojnë;

c) Koordinojnë, monitorojnë dhe sigurojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në nivel rajoni, pranë vendbanimit, për të gjithë qytetarët;

ç) Kryejnë procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndetin publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi, trajnimi etj.) për rajonin përkatës;

d) Bashkëpunojnë me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për çështje të lidhura me financimin e kujdesit shëndetësor;

dh) Bashkërendojnë punën ndërmjet të gjitha strukturave që kanë në varësi.

9. Rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të operatorit miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

10. Marrëdhëniet e punës të drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve të Operatorit në nivel qendror e rajonal, si dhe në njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve shëndetësore, qendrat shëndetësore/klinikat dhe institucionet shëndetesore me shtretër/spitalet rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Rekrutimi i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, mbi bazën e kritereve të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

11. Drejtorët e drejtorive rajonale dhe drejtorët e spitaleve emërohen dhe lirohen nga ministri.

12. Operatori ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Qendrore", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

13. Drejtoritë rajonale kanë stemat, logot dhe vulat zyrtare. Stemat përbëhen nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria rajonale (emri i qarkut ku ka selinë drejtoria)", në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

14. Vula e Operatorit dhe vula e secilës drejtori rajonale ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Operatorit, sipas këtij vendimi, strukturat aktuale vazhdojnë funksionimin e tyre sipas strukturave dhe organikave të miratuara.

2. Numri i punonjësve, asetet dhe fondet e miratuara për drejtoritë e shëndetit publik, drejtoritë rajonale të shëndetësisë, Autoritetin Shëndetësor Rajonal Tiranë, Spitalin Psikiatrik Vlorë, Spitalin Psikiatrik Elbasan riorganizohen sipas Operatorit, në nivel qendror dhe rajonal.

3. Vendimi nr. 394, datë 27.7.2000, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës", shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 134, datë 25.6.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "EDIANI" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: "SHËNGJON 1", ME FUQI TË INSTALUAR 651 kw, "SHËNGJON 2", ME FUQI TË INSTALUAR 356 kw DHE "SHËNGJON 3", ME FUQI TË INSTALUAR 341 kw, ME FUQI TOTALE 1348 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 4, pika 1, germa "a"; nenit 5, pika 1, germa "a"; nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Ediani" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC-et: "Shëngjon 1", "Shëngjon 2" dhe "Shëngjon 3",

konstatoi se:

- Shoqëria "Ediani" sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 421 prot., datë 29.5.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Shëngjon 1", "Shëngjon 2", dhe "Shëngjon 3".

- Aplikimi i shoqërisë "Ediani" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1), plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5, germat "a", "c"), plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3, germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit).

- Nenin 9, pika 4.1.5, germa "b" (leja për përdorimin e ujit).

- Depozitimin në ERE të kontratës shtesë të koncesionit nr. 886 rep. dhe nr. 246 kol. datë 11.9.2016, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI) dhe shoqërisë "Ediani" sh.p.k., për ndërtimin e HEC-eve: "Shengjon 1", "Shengjon 2" dhe "Shengjon 3", të nënshkruar nga të dyja palët.

- Detaje mbi zonën e pronësisë dhe përputhshmërinë e saj me sipërfaqen e HEC-it.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Ediani" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Shëngjon 1", me fuqi të instaluar 651 kw, "Shëngjon 2", me fuqi të instaluar 356 kw dhe

"Shëngjon 3", me fuqi të instaluar 341 kw, me fuqi totale të instaluar 1348 kw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 135, datë 25.6.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "OSOJA HPP" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "OSOJE", ME FUQI TË INSTALUAR 1922 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a"; nenit 5, pika 1, germa "a"; dhe nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Osoja HPP" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Osoje", me fuqi të instaluar 1922 kw,

konstatoi se:

Shoqëria "Osoja HPP" sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Osoje", me fuqi të instaluar 1922 kw, protokolluar në ERE me nr. 430 prot., datë 5.6.2018.

Aplikimi i shoqërisë "Osoja HPP" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "b", "c", "d"; 4.1.4, germat "a", "b", "c", "d", "e"; 4.1.5, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dhënien e miratimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të transferimit të të gjitha të drejtave, kontratat dhe licencat në lidhje me këtë objekt, nga ortakët "Favina" sh.p.k.; "Favina 1" sh.p.k. dhe "Osoja Energy" sh.p.k., te shoqëria "Osoja HPP" sh.p.k., do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Osoja HPP" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Osoje", me fuqi të instaluar 1922 kw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 136, datë 25.6.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "HIDROPOWER ELEKTRIK" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 130, SERIA PV11K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 59, DATË 22.6.2011, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et: "SLABINJA 2A", ME FUQI 2 mw; "SLABINJA 2B", ME FUQI 1.6 mw; "SLABINJA 2C", ME FUQI 1.8 mw; "SLABINJA 2D" DHE "SLABINJA 2E", ME FUQI 3.4 mw, ME FUQI TOTALE 13.8 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 43 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, në lidhje me fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Hydropower Elektrik" sh.p.k., për modifikimin e licencës nr. 130, seria PV11K,

konstatoi se:

- Shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Slabinja 2A", me fuqi 2 mw; "Slabinja 2B", me fuqi 1.6 mw, "Slabinja 2C", me fuqi 1.8 mw; "Slabinja 2D", me fuqi 5 mw dhe "Slabinja 2E", me fuqi 3.4 mw, me fuqi totale 13.8 mw për një periudhë 30-vjeçare, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011.

- Shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k., me shkresën nr. 186 prot., datë 14.5.2018, protokolluar me tonën nr. 393, datë 15.5.2018, ka kërkuar modifikimin e licencës nr. 130, seria PV11K, për HEC-et Slabinja 2.

- Shoqëria koncesionare "Hidropower Elektrik" sh.p.k., po ndërton HEC-et Slabinja 2, mbi lumin Shkumbin, në zbatim të kontratës së koncesionit të formës BOT nr. 2830 rep. dhe nr. 374 kol. datë 3.9.2009, lidhur midis bashkimit të përkohshëm të shoqërive "LNK" sh.p.k. dhe "Euroterma Grup" sh.p.k. dhe METE-s, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, të ndryshuar me kontratën shtesë nr. 7169, rep. dhe nr. 2194 kol. datë 17.6.2013, ndryshuar me kontratën shtesë nr. 760 rep. dhe nr. 204 kol. datë 5.10.2016, ndryshuar së fundmi me kontratën shtesë nr. 1206 rep. dhe nr. 512 kol., datë 15.9.2017. Kjo kërkesë vjen si rrjedhojë e ndryshimeve të skemës së dalë gjatë zbatimit të punimeve që bëri të mundur rritjen e parametrave të fuqisë së instaluar

- Duke qenë se gjatë zbatimit të punimeve për ndërtimin e HEC-eve "Slabinja 2", referuar kërkesës së subjektit, janë hasur probleme të shumta të cilat kanë bërë të domosdoshëm ndryshimin e skemës së shfrytëzimit të HEC-eve, lind nevoja për kryerjen e këtij modifikimi. Më poshtë rendisim disa nga shkaqet që çojnë në këtë modifikim:

- terreni i thyer, i papërshtatshëm dhe me formacione të paqëndrueshme, në territorin ku kalonte ndërtimi i veprave;

- punimet për veprat e derivacionit kalonin në tokat bujqësore të zonës;

- në disa segmente gjurma kalonte në zona natyrore dhe arkeologjike të mbrojtura, për të cilat edhe pse të konstatuara me vonesë, subjekti iu drejtua Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, i cili mbasi shqyrtoi raportin e vëzhgimit sipërfaqësor në kuadër të zbatimit të projektit të HEC-eve: "Slabinja 2B", "Slabinja 2C", "Slabinja 2D & 2D/1" dhe "Slabinja 2E", në zonën e Mokrës, Pogradec, me vendimin nr. 239, datë 7.4.2017, miratoi lejen për këtë projekt.

- Në këtë situatë subjekti iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), me kërkesën për ndryshimin e skemës së shfrytëzimit të HEC-eve "Slabinja 2".

- MEI, me shkresën nr. 73/50 prot., datë 5.7.2017, i ka kërkuar AKBN-së të bëjë oponencën teknike për ndryshimet e projektit të zbatimit "Slabinja 2".

- Referuar oponencës teknike të realizuar nga AKBN-ja, rezulton se është eliminuar HEC-i "2A"

nga skema, për shkak të kostove shumë të larta ekonomike dhe sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është relativisht e vogël, për rrjedhojë është reduktuar numri i HEC-eve të parashikuara për t'u ndërtuar, nga 5 në 4.

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria "Hidropower Elektrik" sh.p.k., në bazë të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", rezulton si më poshtë:

- neni 15, pika 4, germa "a": informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: plotësuar.

- neni 15, pika 4, germa "b": vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: plotësuar.

- neni 15, pika 4, germa "c": miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjerë të licencës, kur këta janë të kushtëzuar me miratimin nga organe të tjera: plotësuar. Është depozituar në ERE nga subjekti shkresa e MEI-t nr. 73/54 prot., datë 4.9.2017, për miratimin e projektit të zbatimit të ndryshuar, për ndërtimin e HEC-eve: "Sllabinja 2B", "Sllabinja 2C", "Sllabinja 2D & 2D/1" dhe "Sllabinja 2E".

- neni 15, pika 4, germa "d": ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi: plotësuar. Reduktimi i numrit të hidrocentraleve nga 5 në 4, zvogëlon kufijtë koncesionare, duke garantuar respektimin e infrastrukturës. Rritja e fuqisë së instaluar të prodhimit të energjisë elektrike nuk sjell asnjë impakt negativ për detyrimet e të licencuarit, sipas legjislacionit në fuqi.

- neni 15, pika 4, germa "e": të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE: plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germa "a" (të dhënat për aplikim); germa "b" (të dhëna identifikuese për aplikuesit); germa "c" (të dhëna për aplikuesin), do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë ato brenda afateve që përcakton "Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike",

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Hidropower Elektrik" sh.p.k., për modifikimin e licencës aktuale me nr. 130, seria PV11K, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: "Slabinja 2A", me fuqi 2 mw; "Slabinja 2B", me fuqi 1.6 mw; "Slabinja 2C", me fuqi 1.8 mw; "Slabinja 2D", me fuqi 5 mw dhe "Slabinja 2E", me fuqi 3.4 mw, me fuqi totale 13.8 mw, për një periudhë 30-vjeçare, në përputhje me ndryshimet sipas kontratës shtesë të koncesionit nr. 1206 rep. dhe nr. 512 kol., datë 15.9.2017.

2. Referuar kontratës shtesë të koncesionit nr. 1206 rep. dhe nr. 512 kol., datë 15.9.2017 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) HEC "Sllabinja 2B", fuqia e instaluar 1.8 mw;

b) HEC "Sllabinja 2C" fuqia e instaluar 3.4 mw;

c) HEC "Sllabinja 2D & 2D/1" (fuqia e instaluar N/1. = 4.885 mw dhe N/2. = 1.200 mw);

d) HEC "Sllabinja 2E", me fuqi të instaluar 3.8 mw.

Fuqia totale e instaluar: N = 15.085 mw

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 137, datë 25.6.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA" PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 322, SERIA F15, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 159, DATË 28.12.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 10, pika 3 dhe nenit 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., për modifikimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 322, seria F15,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 28.12.2014, ka licencuar shoqërinë "Le Trading Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, dhe subjekti është mbajtës i licencës nr. 322, seria F15.

- Subjekti "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 400 prot., datë 17.5.2018, ka bërë më dije se shoqëria "Le Trading Albania" sh.p.k. ka ndryshuar emrin e subjektit dhe atë tregtar si më poshtë:

Emri i ri i subjektit bëhet: "Energia Gas and Power Albania";

Emri i ri tregtar bëhet: "Energia Gas and Power Albania".

- Në vijim të korrespondencës së sipërcituar, ERE, me shkresën nr. 400/1 prot., datë 25.5.2018, i ka bërë më dije subjektit se ndryshimet e bëra emrit të subjektit dhe të reflektuara në QKR, duhet të reflektohen edhe në licencën e furnizimit të energjisë elektrike me nr. 322, seria F15. Si rezultat, subjekti ka detyrimin që në zbatim të nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të aplikojë në ERE për modifikimin e licencës.

- Sa më sipër, subjekti "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., me shkresën nr. 436 prot. i ERE-s, datë 7.6.2018, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike, duke kërkuar ndryshimin e emrit të mbajtësit të saj nga "Le Trading Albania" sh.p.k., në "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k.

- Aplikimi i shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, formati dhe dokumentacioni për aplikim:

- germa "a" (të dhënat për aplikim), plotësuar;

- germa "b" (të dhëna identifikuese për aplikuesit), plotësuar;

- germa "c" (të dhëna për aplikuesin) plotësuar.

- Neni 8, pika 2:

Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin A të kësaj rregulloreje, në shumën 30 000 lekë, plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa "a": informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa "b": vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: pa plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa "c": miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjerë të licencës kur këta janë të kushtëzuar me miratimin nga organe të tjera. Nuk aplikohet në këtë rast kjo kërkesë e rregullores, pasi nga subjekti është bërë vetëm ndryshimi i emrit.

- Neni 15, pika 4, germa "d": ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit. Modifikimi që po kryhet nuk prek detyrimet e të licencuarit sa i përket mbarëvajtjes së punës për llojin e aktivitetit.

- Neni 15, pika 4, germa "e": të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., për modifikimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nr. 322, seria F15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015.

2. Në titull dhe përmbajtje të licencës nr. 322, seria F15, emërtimi "Le Trading Albania" sh.p.k. do të zëvendësohet me emërtimin "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 138, datë 25.6.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 158, SERIA T14, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 133, DATË 24.12.2014

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 10, pika 3; nenit 15 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k. për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 133, datë 24.12.2014, ka licencuar shoqërinë "Le Trading Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar dhe subjekti posedon licencën me nr. 158, seria T14.

- Shoqëria "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 400 prot., datë 17.5.2018, ka bërë me dije se shoqëria "Le Trading Albania" sh.p.k. ka ndryshuar emrin e subjektit dhe atë tregtar, si më poshtë:

Emri i ri i subjektit bëhet: "Energia Gas and Power Albania";

Emri i ri tregtar bëhet: "Energia Gas and Power Albania".

- Në vijim të korrespondencës së sipërcituar, ERE, me shkresën nr. 400/1 prot., datë 25.5.2018, i ka bërë më dije shoqërisë se ndryshimet e bëra emrit të subjektit dhe të reflektuara në QKR, duhet të reflektohen edhe në licencën e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 158, seria T14, si rezultat shoqëria ka detyrimin që në zbatim të nenit 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 15 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit, rinovimit ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të aplikojë në ERE për modifikimin e licencës.

- Sa më sipër, shoqëria "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., me shkresën nr. 436 prot. i ERE-s, datë 7.6.2018, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, duke kërkuar ndryshimin e emrit të mbajtësit të saj nga "Le Trading Albania" sh.p.k., në "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k.

- Aplikimi i shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, formati dhe dokumentacioni për aplikim:

- germa "a" (të dhënat për aplikim): plotësuar;

- germa "b" (të dhëna identifikuese për aplikuesin): plotësuar;

- germa "c" (të dhëna për aplikuesin): plotësuar;
- Neni 8, pika 2:

Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin A të kësaj rregulloreje, në shumën 30 000 lekë: plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa "a": informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës: plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa "b": vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence: pa plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa "c": miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjerë të licencës, kur këta janë të kushtëzuar me miratimin nga organe të tjera. Nuk aplikohet në këtë rast kjo kërkesë e rregullores, pasi nga subjekti kërkohet vetëm ndryshimi i emrit.

- Neni 15, pika 4, germa "d": ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit. Modifikimi që po kryhet nuk prek detyrimet e të licencuarit sa i përket mbarëvajtjes së punës për llojin e aktivitetit.

- Neni 15, pika 4, germa "e": të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k., për modifikimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 158, seria T14, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014.

2. Në titull dhe përmbajtje të licencës nr. 158, seria T14, emërtimi "Le Trading Albania" sh.p.k. do të zëvendësohet me emërtimin "Energia Gas and Power Albania" sh.p.k.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 139, datë 25.6.2018

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "KAMENICA HPP" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "KAMENICË", ME FUQI TË INSTALUAR 800 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 6, germa "b", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; nenit 4, pika 2, germa "c"; nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, vendimit të bordit të ERE-s nr. 153, datë 11.12.2015 "Mbi operimin në treg të prodhuesve me kapacitet të instaluar nën 1 mw dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike", bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi u njoh me relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi mospranimin e shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë "Kamenica HPP" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kamenicë", me fuqi të instaluar 800 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria "Kamenica HPP" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 431 prot., datë 5.6.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kamenicë", me fuqi të instaluar 800 kw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 11.12.2015, "Mbi operimin në treg të prodhuesve me kapacitet të instaluar nën 1 mw dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike", ka vendosur:

1. Vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhen në rrjetin kombëtar për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së prodhimit, nuk pajisen me licencë nga ERE.

2. Prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike të lidhur në rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 mw, nuk pajisen me licencë nga ERE.

3. Kategoritë e prodhuesve dhe të vetëprodhuesve të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n, në çdo rast, që të fillojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e energjisë elektrike.

4. Sa parashikuar më sipër, e gjejmë edhe në nenin 4, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

Për sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos pranojë shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Kamenica HPP" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kamenicë", me fuqi të instaluar 800 kw.

2. Shoqëria "Kamenica HPP" sh.p.k., për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kamenicë", me kapacitet të instaluar nën 1 mw, nuk pajiset me licencë nga ERE.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 140, datë 25.6.2018

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 88, DATË 6.8.2008, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "UNION EOLICA ALBANIA" SHPK, ME NR. 62, SERIA NPM08P, NË VEPRIMTARINË E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARQET EOLIKE KAVAJË

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 16, 104 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", pika 1, germa "e", e vendimit të bordit të ERE-s nr. 88, datë 6.8.2008, "Për licencimin e shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrikë me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Kavajë", pikës 8.5 të kushteve të licencës me nr. 62, seria NPM08P; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shfuqizimin e licencës së shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k.,

konstatoi se:

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 88, datë 6.8.2008, është vendosur "Për licencimin e shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Kavajë", me një afat vlefshmërie të licencës prej 30 vitesh.

- Në pikën 1, germa "e", të vendimit të bordit të ERE-s nr. 88, datë 6.8.2008, përcaktohet se mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

- Referuar dispozitave të përgjithshme licencës pikës 1.2, kjo licencë hyn në fuqi brenda 36 muajsh, duke filluar që nga momenti i miratimit, për

aktivitetin e ndërtimit dhe instalimit të centralit elektrik dhe për një periudhë prej 30 vitesh, për prodhimin e energjisë elektrike.

- Subjekti nuk ka shprehur, si dhe nuk ka paraqitur kërkesë në ERE për zgjatjen e afatit të periudhës së ndërtimit prej nga momenti i licencimit, siç parashikohet në pikën 9.1 të licencës dhe nenin 24, pika 3, të VKM-së nr. 1701, datë 17.12.2008, "Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni".

- Shoqëria "Union Eolica Albania" sh.p.k. nuk ka depozituar në ERE, brenda datës 30 qershor të çdo viti bilancet financiare vjetore, në kundërshtim për sa referuar me pikën 4.2, të licencës me nr. 62, seria NPM08P.

- Shoqëria "Union Eolica Albania" sh.p.k. nuk ka depozituar në ERE, brenda datës 31 mars të çdo viti, raportin vjetor, lidhur me operimet gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, në kundërshtim për sa referuar me pikën 4.3 të licencës me nr. 62, seria NPM08P.

- ERE, me urdhrin nr. 17, datë 4.4.2017, ka ngritur grupin e punës për monitorimin e veprimtarisë së shoqërisë "Union Eolica Albania"sh.p.k., bazuar në pikën 8.1 të licencës nr. 62, seria NPM08P, ku ka rezultuar se shkresat e nisura në adresën e subjektit nga protokolli janë rikthyer në ERE, për shkak të pamundësisë së komunikimit, si rrjedhojë e ndryshimit të adresës së selisë, në kundërshtim për sa referuar me pikën 4.6, germa "a", të licencës me nr. 62, seria NPM08P.

- Shoqëria "Union Eolica Albania" sh.p.k. nuk ka bërë pagesën e rregullimit, për periudhën kohore 2012–2018, në kundërshtim me pikën 13.1, të licencës me nr. 62, seria NPM08P, si dhe nenit 17, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Enti Rregullator i Energjisë kur konstaton se i licencuari nuk ka përmbushur një ose disa nga kushtet e licencës, në referim të pikës 8.5 të kushteve të licencës, mund të rishikojë vlefshmërinë e kësaj licence.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s me nr. 88, datë 6.8.2008, "Për licencimin e shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrikë me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Kavajë".

2. Licenca me nr. 62, seria NPM08P e shoqërisë "Union Eolica Albania" sh.p.k., bëhet e pavlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë "Union Eolica Albania" sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 141, datë 25.6.2018

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.110, DATË 16.9.2008, PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENPOWER ALBANIA" SHPK, ME NR.65, SERIA NPM08P NË VEPRIMTARINË E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË, PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARQET EOLIKE KARABURUN DHE LLOGARA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; neneve 16, 104 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative"; pikës 1, germa "e", të vendimit të bordit të ERE-s nr. 110, datë 16.9.2008, "Për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara"; pikës 8.5 të kushteve të licencës me nr. 65, seria NPM08P; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e

Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për shfuqizimin e licencës së shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k.,

konstatoi se:

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 110, datë 16.9.2008, është vendosur "Për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara".

- Në pikën 1, germa "e", të vendimit të bordit të ERE-s nr. 110, datë 16.9.2008, përcaktohet se mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

- Referuar dispozitave të përgjithshme të licencës, pikës 1.2, kjo licencë hyn në fuqi brenda 36 muajve, duke filluar nga momenti i miratimit, për veprimtarinë e ndërtimit dhe të instalimit të centralit elektrik dhe për një periudhë prej 30 vitesh, për prodhimin e energjisë elektrike.

- Shoqëria nuk ka shprehur, si dhe nuk ka paraqitur kërkesë në ERE për zgjatjen e afatit të periudhës së ndërtimit prej nga momenti i licencimit, siç parashikohet në pikën 9.1 të licencës dhe nenin 24, pika 3, të VKM-së nr. 1701, datë 17.12.2008, "Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni".

- Shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k., nuk ka depozituar në ERE, brenda datës 30 qershor të çdo viti bilancet financiare vjetore, në kundërshtim me sa parashikohet në pikën 4.2, të licencës me nr. 65, seria NPM08P.

- Shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k. nuk ka depozituar në ERE, brenda datës 31 mars të çdo viti, raportin vjetor, lidhur me operimet gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, në kundërshtim me sa parashikohet në pikën 4.3 të licencës me nr. 65, seria NPM08P.

- Korrespondencat e nisura në adresën e subjektit janë rikthyer në ERE dhe rezulton se subjekti ka ndryshuar adresën e selisë pa njoftuar ERE-n për këtë, në kundërshtim me sa referohet në pikën 4.6 germa "a", të licencës me nr. 65, seria NPM08P.

- Shoqëria "Enpower Albania" sh.p.k. nuk ka bërë pagesën e rregullimit, për periudhën kohore 2012–2018, në kundërshtim me pikën 13.1 të licencës me nr. 65, seria NPM08P dhe nenit 17, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Enti Rregullator i Energjisë, kur konstaton se i licencuari nuk ka përmbushur një ose disa nga kushtet e licencës, në referim të pikës 8.5 të kushteve të licencës, mund ta rishikojë vlefshmërinë e kësaj licence.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të ERE-s me nr. 110, datë 6.9.2008, "Për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k. në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrikë me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara".

2. Licenca me nr. 65, seria NPM08P e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., bëhet e pavlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë "Enpower Albania" sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 142, datë 25.6.2018

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 8, DATË 4.2.2009, "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENPOWER ALBANIA" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a"; të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 16; 104 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative"; nenit 15, të "Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96,

datë 17.6.2016; pikës 3.5.2, pikës 3.5.4, germa "a", pikës 3.7.1 dhe pikës 4.4, pikës 5.1, germa 'b", të "Kushteve licencës së tregtimit të energjisë elektrike", me nr. 75, seria T09P, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, pasi shqyrtoi, relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi shfuqizimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, të shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., me nr. 75, seria T09P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 8, datë 4.2.2009, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Subjekti "Enpower Albania" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 8, datë 4.2.2009, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe është mbajtës i licencës me nr. 75, seria T09P.

- Vendimi i sipërcituar është ndryshuar më pas me atë me nr. 10, datë 20.2.2009, i cili ka ndryshuar afatin e vlefshmërisë së kësaj licence nga 5 vjet në 30 vjet.

- Subjekti ka shkelur kushtet e licencës së dhënë nga ERE, si më poshtë:

- nga të dhënat e përditësuara të marra nga Drejtoria e Administrim-Financës lidhur me pagesat e rregullimit, për llogari të ERE-s, nga subjekti nuk është bërë pagesa e rregullimit, për periudhën viti 2012–2018, në kundërshtim me pikën 3.7.1 të kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, ku përcaktohet, se i licencuari është i detyruar të paguajë në ERE pagesën e licencës ose pagesa të tjera të aplikueshme, sipas nenit 12, të ligjit të nr. 9072, datë 22.5.2002, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe shprehur në këtë të fundit në nenin 17, për pagesat e rregullimit;

- referuar pikës 3.5.2 të licencës, të licencuarit i kërkohet të përgatisë dhe të paraqesë në ERE më 31 janar të çdo viti një raport vjetor, lidhur me operimet e tij, gjatë vitit të mëparshëm kalendarik. Nga verifikimet e bëra për këtë qëllim nuk rezulton të ketë depozituar një akt të tillë në ERE, në kundërshtim për sa referuar në pikën 3.6.2 të licencës;

- subjekti ka ndryshuar selinë pa njoftuar ERE-n, në kundërshtim me pikën 3.5.4, germa "a" (detyrime të licencuarit për adresën) të licencës, në referim të së cilës i licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim;

- referuar pikës 4.4 të licencës, kur ERE konkludon se i licencuari nuk ka respektuar kushtet e licencës, ERE mund të rishikojë vlefshmërinë e licencës;

- sa pasqyrohet më sipër, licenca e tregtimit të shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k. e ka humbur legjitimitetin e saj, për shkak të shkeljes së kushteve të sanksionuara në vetë licencën dhe kuadrin ligjor që vepron në sektorin e energjisë elektrike;

- bordi i ERE-s, me vendimin nr. 141, datë 25.6.2018, ka vendosur, "Mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 110, datë 16.9.2008, për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., me nr. 65, seria NPM08P, në veprimtarinë e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, prodhimin e energjisë elektrike nga parqet eolike Karaburun dhe Llogara.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin nr. 8, datë 4.2.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për licencimin e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike", i ndryshuar.

2. Licenca me nr. 75, seria T09P, e shoqërisë "Enpower Albania" sh.p.k., bëhet e pavlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë "Enpower Albania" sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 143, datë 25.6.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "ALESIO-2014" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "FUSHË-ARRËZ", ME FUQI TË INSTALUAR 1990 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1 germa "a" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC "Fushë-Arrëz",

konstatoi se:

- Shoqëria "Alesio 2014" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 420 prot., datë 28.5.2018, ka paraqitur kërkesë për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Fushë-Arrëz".

- Aplikimi i shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "b", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "c", "d"; 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë, me:

- Nenin 9, pika 2, germa "d" (vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata);

- Nenin 9, pika 3, germat "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe sigurimeve shoqërore) dhe "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);

- Nenin 9, pika 4.1.3, germa "b" (një diagram elektrike në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Fushë-Arrëz", me fuqi të instaluar 1990 kw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 144, datë 25.6.2018

MBI RISHIKIMIN E "METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT", MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 201, DATË 4.12.2017

Në mbështetje të neneve 16; 19, germa "b"; 20, germa "a"; dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe nenit 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, në lidhje me rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, në zbatim të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, miratoi "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 104, datë 30.4.2018, miratoi fillimin e procedurave për rishikimin e "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017 të bordit të ERE-s.

- Në procedurën e nisur me vendimin nr. 104, datë 30.4.2018, për rishikimin e metodologjisë ekzistuese, u propozuan ndryshimet në vijim:

1. Formula përllogaritëse e çmimit FMF në nenin 8 të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017 të bordit të ERE-s, të jetë:

ÇFMFt = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA)

ku:

CBEt: çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE).

Pr: kthim për riskun i përcaktuar për vitin

CA: kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

2. Pas pikës 8.1, shtohet pika 2 me përmbajtje si më poshtë:

2. Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë te klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014.

- ERE, me urdhër nr. 38 datë 7.5.2018, organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e OSHEE sh.a., MIE-t dhe Autoritetit të Konkurrencës.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 8814/1, datë 24.5.2018, përcolli komentet në lidhje me ndryshimet e propozuara në vendimin nr. 104, datë 20.4.2018 të bordit të ERE-s, si më poshtë:

1. Rishikimi i metodologjisë dhe arsyet e përmendura në vendimin e bordit të ERE-s nr. 104, datë 30. 4.2018, për rishikimin e saj, nuk përkojnë me situatën aktuale, sepse:

a) OSHEE sh.a. nuk ka ndarje të llogarive midis aktivitetit të furnizimit dhe shpërndarjes dhe vijon të mos ketë ndarje të tyre edhe sot. Këto llogari vijojnë të ndahen aktualisht me metodologjinë e dakordësuar edhe me ERE-n, deri në datën 1.1.2019, kur OSHEE sh.a. do të ndahet si shoqëri.

b) OSHEE sh.a. nuk ka pasur një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit dhe kostot e disbalancave kur u miratua metodologjia më 4.12.2017 dhe vijon mos ta ketë edhe sot.

c) Pavarësisht se OSHEE sh.a. kishte filluar apo jo si FMF, si dhe pavarësisht faktit që klientët si FMF do të furnizohen për 60 apo 720 ditë metodologjia konsiderohet se duhet të jetë e pandryshueshme.

2. Vendosja e një çmimi minimum mund të ndikojë në paanësinë e Operatorit Publik në ofrimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, në favor të klientëve të 35KV, si dhe mund të rëndojë pozitën e klientëve të OSHEE sh.a. Vendosja e një çmimi dysheme, nuk përkon me aplikimin e një metodologjie çmimi për klientët në fjalë. Në këtë kuadër, jemi të mendimit që pika 8.2 të hiqet.

3. Në metodologji janë përfshirë elemente të reja Pr apo CA, por nuk sqarohet se përfaqësojnë ato në tarifë, rolin e tyre, si dhe mënyrën e llogaritjes gjate vitit 2018. Ku do të mbështetet OSHEE për llogaritjen e tyre, te të dhënat

paraprake që përdoren gjatë aplikimit për tarifë apo në të dhënat përfundimtare pas konsolidimit të bilancit financiar?

4. Treguesi CBEt i cili përfaqëson çmimin maksimal të blerjes së energjisë në treg të parregulluar apo i blerjes nga PPEE-ja, a do të mund të aplikohet pas vitit 2018, kur energjia e PPEE-së do të jetë kosto për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për mbulimin e humbjeve dhe funksioni i FMF-së mbetet detyrim funksional i FSHU-së.

- Në lidhje me sa arsyetuar nga OSHEE sh.a., ERE sqaroi se:

- Metodologjia e paraqitur është përgatitur për të shërbyer për një periudhë të gjatë dhe jo për një operator të caktuar të furnizimit me energji elektrike si OSHEE sh.a., por në kushtet e një shoqërie që kryen disa funksione dhe me stadin aktual të organizimit, aplikimi i saj është problematik.

- "FMF-ja duhet të mbajë llogari të ndara për furnizimin e konsumatorëve sipas shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, nga furnizimi i konsumatorëve nga shërbimi i FSHU-së (Furnizuesi i Shërbimit Universal), si dhe çdo furnizim tjetër tregtar. Këto të dhëna duhet të jenë në dispozicion të ERE-s sa herë që kërkohet prej saj".

- Mosekzistenca në OSHEE sh.a. e strukturës për evidentimin e kostove administrative dhe të disbalancave për konsumatorët e FMF-së nuk përbën argument. ERE nuk ka penguar në lejimin dhe njohjen e kostove për ngritjen e një strukture të tillë, e cila do të ndihmonte në ndarjen e saktë të kostove midis klientëve të FSHU-së dhe FMF-së, për sa kohë që ato janë të arsyeshme dhe të justifikuara.

- "FMF-ja ka detyrimin të blejë energji elektrike me shumicë në emër të konsumatorëve të furnizuar prej tij dhe të jetë përgjegjës për balancimin e mbetjes për një furnizim të tillë me shumicë".

- Zgjatja e afatit të shërbimit nga 60 ditë në 2 vjet krijon lehtësi për përcaktimin e kostove administrative për kwh të furnizuar nga ana e OSHEE sh.a. Kjo për shkak të krijimit të mundësisë së parashikimit të kostove operative të furnizimit si aktivitet në tërësi për periudha vjetore, e më tej të alokimit të tyre midis klientëve të FSHU-së dhe atyre të FMF-së.

- Në praktikën e deritanishme janë vërejtur interferenca në shpenzimet për blerje energjie ndërmjet funksionit të FMF-së dhe FSHU-së.

- ERE në metodologji, siguron mosfavorizim të klientëve të FMF-së në dëm të klientëve të FSHU-së nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të vazhdueshëm për përcaktimin e çmimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sikurse parashikohet në pikën 3, të nenit 10, të metodologjisë.

- Referimi i një çmimi dysheme për klientët FMF ekuivalent me atë të klientëve në të njëjtat kushte (nivel tensioni, kategori konsumatorësh) të FSHU-së është i nevojshëm për të shmangur situata të tilla ku çmimi i klientëve FMF rezulton më i ulët, ndërkohë që energjia për këta konsumatorë blihet në treg me çmime që në çdo rast rezultojnë më të larta se miksi i energjisë (KESH 1.5 lekë/kwh-treg) për klientët e FSHU-së. Kjo si rezultat i pamundësisë/paaftësisë së shoqërisë për të paraqitur dhe alokuar të gjitha kostot respektive për shërbimin e klientëve FMF.

- Siç është sqaruar edhe në vendimin për fillimin e procedurës së disa ndryshimeve të metodologjisë:

- CA përfaqëson kostot administrative/ operative në lekë për çdo kwh të furnizuar nga ana e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (nënkupton kostot operative, kostot e borxhit të keq dhe koston e kapitalit të punës për aktivitetin e furnizimit)

- Për përcaktimin dhe axhustimin e CA Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të zbatojë përcaktimet e nenit 6 të metodologjisë, i cili parashikon korrigjimin sipas parimit ex-post.

- Pr përfaqëson kthimin për riskun dhe do të jetë një përqindje fikse e aplikuar mbi koston e blerjes së energjisë nga FMF-ja sipas përcaktimeve në pikën 4, të nenit 6, e cila duhet t'i kthejë furnizuesit një kthim të arsyeshëm në mënyrë që të kompensojë riskun e tij të furnizimit. Nisur nga benchmarku apo nga praktikat më të mira ky kthim nuk do të kalojë nivelin prej 3%.

- Referimi te çmimi i blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi (BRE) përveç tregut të parregulluar pas vitit 2018 për përcaktimin e CBEt (çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit) mbështetet në faktin që sasia e energjisë së blerë nga BRE-ja (sikurse

detyron VKM-ja nr. 244) përtej nevojës për mbulimin e humbjeve të OSSH-së do të kalojë për mbulimin e kërkesës për klientët FMF.

Në përfundim të afatit për marrjen e opinionit dhe vërejtjeve të palëve të interesit, në lidhje me ndryshimet e propozuara në metodologjinë e përcaktimit të çmimit për FMF, të cilat janë publikuar edhe në faqen e internetit të ERE-s, nuk ka pasur komente të tjera nga palë interesi (përveç OSHEE sh.a.) apo nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rishikimin e nenit 8 të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të bordit të ERE-s, si vijon:

Neni 8 ndryshon dhe bëhet:

a) Llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të bëhet sipas formulës së mëposhtme:

ÇFMFt = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA)

Ku:

CFMFt: Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

Ku:

CBEt është çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE).

Pr: Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (do të pranohet në masën 3% për dy vitet e para e më tej do të rishikohet bazuar në të dhënat historike)

TRrTSHt: Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t

CA: Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

b) Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë te klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, kur këtë funksion e ushtron OSHEE/FSHU.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 201, DATË 4.12.2017, TË BORDIT TË ERE-s, E NDRYSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 144, DATË 25.6.2018

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo metodologji hartohet në zbatim të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe në përputhje me Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie, është përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim, dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente.

Neni 3
Objekti

Objekti i kësaj metodologjie është llogaritja e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për konsumatorët fundorë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 86, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Neni 4
Zbatimi

Kjo metodologji do të zbatohet për të licencuarin e ngarkuar për shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e energjisë elektrike, i caktuar në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 87, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Neni 5
Përkufizime

Fjalët dhe frazat e përdorura në këtë metodologji do të kenë kuptimet e mëposhtme:

a) **Ligji për energjinë** do të thotë ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

b) **Bordi i ERE-s** do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

c) **ERE** do të thotë autoriteti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjin nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror."

d) **Licencë** është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror".

e) **Furnizues i Mundësisë së Fundit** (FMF) do të thotë një person i pajisur me licencë për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, i caktuar nga ERE për të ushtruar funksionin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit sipas ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike". Ai ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj konsumatorëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.

f) **Çmimi i Furnizimit të Mundësisë së Fundit** do të thotë çmimi i ofruar nga furnizuesi për të mbuluar kostot e tij të arsyeshme për të siguruar furnizimin me energji elektrike për periudhën për sa është caktuar si Furnizues i Mundësisë së Fundit.

g) **Kosto direkte të furnizimit me pakicë** do të thotë kosto administrative (që nuk lidhen me energjinë) që lidhen me kryerjen e funksionit të FMF-së, e që miratohet nga ERE.

h) **Procedurë** do të thotë tërësia e veprimeve, që kryhen për zbatimin e legjislacionit në fuqi.

PJESA E DYTË
PËRCAKTIMI I ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT

Neni 6
Metodologjia për përcaktimin e çmimeve të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

1. Çmimi për grupe të ndryshme të konsumatorëve mund të ndryshojë vetëm deri në atë masë sa ndryshon profili i ngarkesës së grupeve të konsumatorëve.

2. Axhustimi/korrigjimi i kostos direkte do të bëhet sipas parimit ex-post.

3. Tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te konsumatorët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit i cili vendoset nga Rregullatori.

4. FMF-ja në çdo rast, duhet ta sigurojë energjinë për furnizimin e konsumatorëve të kësaj kategorie, duke e blerë në treg të parregulluar në përputhje me Rregulloren e miratuar nga ERE me vendimin nr. 103, datë 23.6.2016 ose nga prodhuesit me përparësi.

5. Kostot e imbalancave do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera fuqi.

6. Marzhi i furnizimit do të jetë një përqindje fikse e aplikuar mbi koston e blerjes së energjisë nga FMF-ja sipas përcaktimeve në pikën 4 të nenit 6, e cila duhet t'i kthejë furnizuesit një kthim të arsyeshëm në mënyrë që të kompensojë riskun e tij të furnizimit.

7. Marzhi me pakicë nuk duhet të kalojë normën prej 3% të kostot së blerjes së energjisë elektrike.

8. Konsumatorët e FMF-së do të paguajnë tarifat përkatëse të furnizimit, si dhe të gjitha tarifat përkatëse të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, në përputhje me nivelin e tensionit ku konsumatori furnizohet.

9. Kostot, të cilat varen nga vëllimi i energjisë elektrike të furnizuar, do të pasqyrohen në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe do të reflektojnë koston reale të furnizimit, e cila do të monitorohet nga Rregullatori në mënyrë periodike.

10. FMF-ja do të kërkojë nga konsumatorët e tij që të depozitojnë një garanci bankare të barabartë me vlerën financiare të furnizimit të pritshëm, vlerë kjo e dakordësuar në marrëveshjen mes palëve, e cila do të çlirohet menjëherë me likuidimin e detyrimeve financiare mes palëve.

Neni 7

Aplikimi për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike për furnizimin nga FMF-ja

1. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, jo më vonë se data 5 e muajit pasardhës, do të paraqesë në ERE aplikimin për përcaktimin e çmimit për shitjet e energjisë elektrike për qëllime të Furnizimit të Mundësisë së Fundit për muajin aktual. Ky aplikim do të përfshijë të gjitha kostot e identifikuara nga Furnizuesi, sipas nenit 6 të kësaj metodologjie.

2. Deri në përcaktimin e çmimit nga ERE, Furnizuesi do të faturojë konsumatorin e furnizuar në kushtet e furnizimit të mundësisë së fundit, me çmimin më të lartë të blerjes së energjisë elektrike për periudhën në të cilën furnizohet, të publikuar nga FMF-ja, duke pasqyruar kostot administrative, e transmetimit/shpërndarjes, sipas nivelit të tension ku është i lidhur konsumatori, si dhe kostot e përcaktuar në pikën 6, të nenit 6.

3. ERE në çdo rast, do të vendos çmimin e shitjes së energjisë elektrike për Furnizuesin e Mundësisë së fundit jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e aplikimit. Brenda kësaj periudhe, ERE mund të vendosë për zhvillimin e seancave dëgjimore.

4. Jo më vonë se 5 ditë nga vendimi i ERE-s për korrigjimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike sipas pikës 2 të këtij neni, mes palëve do të lëshohet një faturë me të gjitha kompensimet për diferencat ndërmjet çmimit të faturuar sipas pikës 3 të këtij neni dhe çmimit të përcaktuar nga ERE.

Neni 8

Llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

1. Llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, do të bëhet sipas formulës së mëposhtme:

ÇFMFt = CBEt +Pr CBEt+ TRrTSHt+CA)*

Ku:

CFMFt: Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

CBEt është çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE)

Pr: Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (do të pranohet në masën 3% për dy vitet e para e më tej do të rishikohet bazuar në të dhënat historike)

TRrTSHt: Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante t

CA: Kostoja administrative e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

2. Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë te klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. 148, datë 26.12.2014, kur këtë funksion e ushtron OSHEE/ FSHU.

Neni 9

Detyrime të tjera

1. Çmimi i llogaritur sipas përcaktimeve të nenit 6 të kësaj metodologjie, nuk përfshin detyrimet në lidhje me incentivimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe detyrimet e tjera tatimore, të cilat Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është i detyruar t'i identifikojë në një zë të veçantë në faturën e shitjes së energjisë elektrike për konsumatorin fundor të furnizuar prej tij.

2. FMF-ja ka detyrimin të blejë energji elektrike me shumicë në emër të konsumatorëve të furnizuar prej tij dhe të jetë përgjegjës për balancimin e mbetjes për një furnizim të tillë me shumicë.

3. FMF-ja ka detyrimin e informimit të konsumatorëve për kushtet e shërbimeve të ofruara prej tij.

4. FMF-ja ka detyrimin e dorëzimit të kontratave të furnizimit te konsumatorët që do të furnizohen prej tij, brenda 8 ditëve nga fillimi i furnizimit.

5. FMF-ja duhet të furnizojë konsumatorët që furnizohen prej tij, për një periudhë jo më të gjatë se afati i parashikuar në nenin 3, të ligjit nr. 7/2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, si dhe t'i ndihmojë që të gjejnë një furnizues alternativ brenda këtij afati.

Neni 10
Monitorimi i çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

1. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të dorëzojë dhe të argumentojë në ERE, për çdo muaj, të gjitha kostot, bazuar në elementet e këtij çmimi, siç përcaktuar në nenin 6 të kësaj metodologjie.

2. FMF-ja duhet të mbajë llogari të ndara për furnizimin e konsumatorëve sipas shërbimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, nga furnizimi i konsumatorëve nga shërbimi i FSHU-së (Furnizuesi i Shërbimit Universal), si dhe çdo furnizim tjetër tregtar. Këto të dhëna duhet të jenë në dispozicion të ERE-s sa herë që kërkohet prej saj.

3. ERE do të monitorojë dhe kontrollojë përcaktimin e çmimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Neni 11
Publikimi

I licencuari i caktuar me shërbimin e Furnizimit të Mundësisë së Fundit ka detyrimin të mirëmbajë dhe të publikojë në faqen e internetit, informata rreth shërbimit të Furnizimit të Mundësisë së Fundit, tarifat e furnizimit për muajt paraardhës për kategori të ndryshme të konsumatorëve dhe vlerësimin e përafërt për tarifat që mund të aplikohen në muajin pasardhës për konsumatorët që mund të furnizohen nga ky furnizues.

PJESA E TRETË
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12
Interpretimi

Në rast se, një çështje nuk është trajtuar në këtë metodologji, ERE do të vendosë rast pas rasti dhe do të nxjerrë udhëzimet sipas kërkesave përkatëse.

Neni 13
Dispozita tranzitore

Llogaritja e çmimit të energjisë së furnizuar në kushtet e Furnizimit të Mundësisë së Fundit, para hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, do të korrigjohet në përputhje me kriteret e përcaktimit të çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të përcaktuar në këtë metodologji.

Neni 14
Amendime të rregullores

Kjo metodologji është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të bordit të ERE-s, si dhe në përputhje me rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo metodologji u miratua me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 145, datë 25.6.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E ALOKIMIT TË SHOQËRISË "FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË" SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19 pika 1, germa "a", të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar me tonën nr. 355 prot., datë 30.4.2018, OSHEE sh.a., ka përcjellë dokumentacionin për transferimin e licencave dhe licencimin e shoqërive të kontrolluara nga ana e saj. Ndër to, është edhe dokumentacioni i shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. (FTL sh.a.), për

licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 2/1 prot., datë 28.5.2018, FTL sh.a., ka paraqitur në ERE kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë FTL sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.7) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë "FTL" sh.a., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 146, datë 25.6.2018

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 86, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, nenit 15 të "Rregullores për organizimi, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", për muajin qershor 2018,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 11930 prot., datë 11.6.2018, paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin qershor 2018.

- Nga analiza që iu bë aplikimit të OSHEE sh.a. mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, rezulton se sipas llogaritjeve të OSHEE sh.a., çmimi për muajin qershor 2018, është 9,82 lekë/kwh.

- Edhe në aplikimin e çmimit të FMF-së për muajin qershor 2018 vërehen të njëjtat dukuri sikurse konstatuar edhe për periudhën janar–maj 2018. OSHEE sh.a. nuk ka mundur të alokojë shpenzimet administrative për aktivitetin e FMF-së. Kjo praktikë mund të rezultojë në favorizim të klientëve të FMF-së nëpërmjet transferimit të kostove të tyre te kostot e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e tjerë fundorë që furnizohen nga FSHU-ja. Rrjedhimisht, u konstatua se, me përjashtim të muajit janar 2018, kostot e raportuara nga OSHE/FMF përgjatë periudhës janar–maj rezultuan më të ulëta se sa çmimet me pakicë për klientët fundorë të furnizuar në atë nivel tensioni nga FSHU-ja, kur këto çmime me pakicë kanë përfaqësuar kostot reale të shërbimit të shoqërisë.

- OSHEE sh.a. nuk ka llogaritur dhe faturuar kostot e disbalancave për klientët e FMF-së, veprim i cili duhet të vazhdojë të kryhet nga FSHU-ja si detyrim ky i përcaktuar në rregullat e tregut dhe rregulloren e disbalancave, si dhe siç është përcaktuar në nenin 6 të metodologjisë.

- Nga verifikimi i informacionit dhe përllogaritjeve të paraqitura nga shoqëria rezulton një çmim prej 9.82 lekë/kwh, pra më i madh se

çmimi "dysheme" 9.5 lekë/kwh. Rrjedhimisht, çmimi i FMF-së për muajin qershor 2018 propozohet të jetë çmimi 9.82 lekë/kwh (në mungesë të një çmimi referues të ndryshëm nga ai prej 9,5 lekë/kwh).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 9.82 lekë/kwh për muajin qershor 2018.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 148, datë 28.6.2018

MBI KËRKESËN E OSHEE SHA PËR KONTESTIMIN E VENDIMIT NR. 110, DATË 14.5.2018, TË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME KORRIGJIMIN E FATURAVE PËR SHËRBIMIN E BALANCIMIT, SIPAS PARASHIKIMEVE TË AKTEVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUQI DHE PËRLLOGARITJEVE NGA OST SHA, TË RAKORDUARA DHE TË PRANUARA NGA PALËT PËRGJEGJËSE PËR PERIUDHËN 1 KORRIK 2016–31 DHJETOR 2017"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 16 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, mbi kërkesën e OSHEE sh.a., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 110, datë 14.5.2018, "Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me korrigjimet e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përllogaritjeve nga OST sh.a. të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2017",

konstatoi se:

Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën e saj nr. 9804, prot., datë 28.5.2018, protokolluar në ERE me nr. 404/1 prot., datë 30.5.2018, ka përcjellë në ERE kontestimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 110, datë 14.4.2018.

Në këtë korrespondencë, OSHEE sh.a. bën me dije se:

Është njohur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 110, datë 14.5.2018 "Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me korrigjimin e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përllogaritjeve nga OST sh.a., të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2017".

Shoqëria OSHEE sh.a. shpreh mosdakordësinë e saj në zbatimin e këtij vendimi pasi zbatimi i tij do të shkaktonte efekte të larta financiare për shoqërinë.

OSHEE sh.a. shprehet se "ashtu siç përmendet edhe në vendimin e sipërcituar faturat e disbalancave për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2017 janë përllogaritur në mënyrë korrekte nga shoqëria OST sh.a., bazuar në mekanizmin e llogaritjes së disbalancave sipas "Rregullave të përkohshme të tregut", miratuar me vendimin nr. 139/2016 të ERE-s.

OSHEE sh.a., në vijim të shkresës nr. 9804, prot., datë 28.5.2018, protokolluar në ERE me nr. 404/1 prot., datë 30.5.2018, ka paraqitur në ERE gjithashtu, shkresën me nr. 9804/1 prot., datë 29.5.2018, e protokolluar me tonën nr. 404/3, datë 13.6.2018.

Në këtë korrespondencë, OSHEE sh.a. ka depozituar "Shtesë ankimi administrativ mbi vendimin nr. 110, datë 14.5.2018, "Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me korrigjimin e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përllogaritjeve nga OST sh.a., të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2017".

Në këtë komunikim, OSHEE sh.a., bën me dije se:

- në datën 23.5.2018, ka marrë dijeni mbi vendimin e ERE-s nr. 110, datë 14.5.2018.

- OSHEE sh.a., gjithashtu, bën me dije se këtë ankim e ka paraqitur në kuadër të parashikimeve të nenit 16 të Rregullave të procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

- OSHEE sh.a., nga data 1 janar 2018 e në vijim ka pranuar dhe zbatuar Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë, miratuar me vendimin nr. 193, datë 24.11.2017 të ERE-s.

- OSHEE sh.a. në vijim edhe të shkresës nr. 9804/1 prot., datë 30.5.2018, depozituar në ERE në datën 13.6.2018, nuk është dakord me këtë vendim të ERE-s, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

- Vendimi referon një periudhë kohore 1 korrik 2016–31 dhjetor 2017, periudhë për të cilën ka pasur rregullim mes palëve. (Ky rregullim provohet nga faturat tatimore të pranuar dhe konfirmuara...)

- Ky - vendim sjell një impakt financiar për OSHEE sh.a.

- Pasqyrat financiare të OSHEE sh.a., për vitet 2016 dhe 2017 janë mbyllur dhe janë depozituar në institucionet përkatëse.

- Faturat e rakorduara dhe të pranuara nga palët OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. janë reflektuar në mbylljen e bilancit financiar të shoqërisë OSHEE sh.a. për pjesën e dytë të vitit 2016 dhe 2017.

- Ky vendim i jep fuqi prapavepruese aktit dhe referuar teorisë së të drejtës administrative dhe në veçanti KPA, neni 105, fuqi prapavepruese e aktit është një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm dhe aktet administrative mund të kenë fuqi prapavepruese, konkretisht:

c) Organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

Lidhur me ankimin e OSHEE sh.a. sipas shkresave 9804, datë 28.5.2018 dhe 9804/1, datë 30.5.2018 (depozituar në ERE, në datën 13.6.2018), konstatohet se:

- Shoqëria OSHEE sh.a. ka marrë dijeni për vendimin nr. 110, datë 14.5.2018, të bordit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 404 prot., datë 22.5.2018 (depozituar në OSHEE sh.a., në datën 23.5.2018, konfirmuar nga OSHEE sh.a. në shkresën nr. 9804/1, datë 30.5.2018);

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën e saj nr. 9804, datë 28.5.2018, ka përcjellë në ERE kontestimin e vendimit nr. 110, datë 14.5.2018;

- Pika 5, e nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe nenit 16 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016", parashikon se: "Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.".

- Në lidhje me afatet e depozitimit të kërkesës nr. 9804, datë 28.5.2018, konstatojmë se është respektuar afati prej 7 ditësh kalendarike duke qenë se subjekti ka marrë dijeni në datën 24.5.2018 dhe ka paraqitur ankesën në datën 30.5.2018.

OSHEE sh.a., në ankimimin e saj, pretendon se parashtron si provë të re, efektet e larta financiare, ndaj OSHEE sh.a. Këtë pohim OSHEE sh.a. e ka parashtruar në datën 24.4.2018, ku u zhvillua takimi me prezencën e përfaqësuesve të ERE-s, KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. Gjatë takimit nga ana e OSHEE sh.a., ndër të tjera, u shpreh se do të respektojë mekanizmin balancues që ka qenë në atë kohë siç po respekton të tanishmin dhe se korrigjimet kanë efekt financiar.

Sa i takon impaktit financiar tek OSHEE sh.a., të kësaj vendimmarrje, konstatohet se ky pretendim është pjesë e konstatimeve edhe në vendimin nr. 110, datë 14.5.2018, ku në faqen 4–5 të këtij vendimi thuhet:

Faturat e lëshuara nga OST sh.a. për disbalancat janë firmosur dhe pranuar nga të dyja palët.

Problematika e disbalancave shtrihet në periudhën 1 korrik 2016–dhjetor 2017 pikërisht në periudhën kur OSHEE sh.a. është bërë palë përgjegjëse për balancim në bazë të ligjit.

Problematika e shkaktuar vjen nga Prodhuesit me Përparësi të Energjisë të lidhur në rrjetin e transmetimit dhe atë të shpërndarjes të cilat nuk janë subjekt i disbalancave, por të gjithë energjinë e

prodhuar janë të detyruar ta shesin tek OSHEE sh.a. dhe tashmë janë zhveshur nga llogaritjet për të cilat OSHEE sh.a. nuk ka të dhëna në frekuencat kohore që përkojnë me nominimet dhe komponentët që nevojiten për zbatimin e mekanizmit llogaritës së disbalancave, ndërkohë kjo disbalancë pozitive është e pasqyruar vetëm në fatura dhe nuk është energji e prodhuar apo e lëvruar në rrjet.

Propozimi për ndryshimin e mekanizmit llogaritjes së disbalancave është paraqitur nga OST sh.a. në ERE në tetor 2016, por duke qenë se komponentë që nevojiten për zbatimin e këtij mekanizmi ishin dhe PPE (të cilët ligji nr. 138/2013, "Për burimet e energjisë së rinovueshme", si dhe më pas ligji nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", neni 22, pika 5, i përjashton nga detyrimi për kostot e disbalancave të shkaktuara deri më 31 dhjetor 2022), si dhe HEC Ashta, i cili trajtohet me marrëveshje të veçantë PPA, e cila trajton përgjegjësinë për balancim në mënyrë specifike, si dhe ligji për energjitë e rinovueshme; rregullat e tregut dhe të balancimit në atë kohë ishin në proces amendimi, si dhe jo të gjitha palët shprehen dakordësinë për këtë propozim të OST sh.a., u vendos që kjo e fundit të vijonte trajtimin e disbalancave sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në atë kohë deri me amendimin e këtyre akteve.

Impakti financiar që do të vijë nga korrigjimi i faturave do të reflektohet tek OSHEE-ja.

Korrigjimi nuk do të ketë impakt në bilancin energjetik, i cili bazohet në matje, ndërsa disbalancat nuk janë fluks energjie pasi është vetëm programim. Dhe tek OSHEE do të reflektohet vetëm si vlerë dhe afektohet vetëm bilanci financiar.

Korrigjimi i faturave do të bëhet muaj për muaj për të dyja kompanitë.

Llogaritja e disbalancave duhej bërë me programimin dhe matjen e KESH sh.a. që në fillim.

Mekanizmi i llogaritjes ka qenë dhe është i rregullt, por ndryshon vetëm mënyra e programit të përdorur.

Sa më sipër, kërkesa nr. 9804, datë 28.5.2018 e OSHEE sh.a., nuk përmban prova të reja siç kërkohet në nenin 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Lidhur me korrespondencën nr. 9804/1, datë 30.5.2018, protokolluar në ERE në datën 13.6.2018, konstatohet se ky komunikim është paraqitur përtej afatit 7–ditor të përcaktuar në ligjin e sipërcituar.

Lidhur me pretendimet e parashtruara nga OSHEE sh.a. në këtë komunikim mbi prapaveprueshmërinë e vendimit nr. 110, datë 14.5.2018, vërehet se qartësisht edhe në vendimin nr. 110/2018 të ERE-s, në faqen 5 të tij sqarohet se:

Rregullat e Përkohshme të Tregut, përcaktojnë në kapitullin XI.2.3:

Në rast mosmarrëveshje, pjesëmarrësi është i detyruar të paguajë shumën korresponduese në përputhje me udhëzimet për nxjerrjen e faturave të nxjerrë nga OST-ja; mosmarrëveshja nuk vonon ekzekutimin e detyrimeve. Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes do të bëhet korrigjimi i faturës, po të jetë e nevojshme.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s duke konstatuar se ankimi i OSHEE sh.a. nr. 9804, datë 28.5.2018, nuk përmban prova të reja dhe korrespondenca vijuese nr. 9804/1 prot., datë 30.5.2018 (depozituar në datën 13.6.2018) në ERE, është bërë jashtë afateve ligjore, e si të tillë nuk plotëson mund të çojë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai i ankimuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e OSHEE sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 110, datë 14.5.2018, "Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., lidhur me korrigjimin e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përllogaritjeve nga OST sh.a., të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016–31 dhjetor 2017", mbështetur në pikën 5, të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe nenin 16, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë kërkuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 149, datë 28.6.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "DON – UCD" SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "DON – UCD" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 475, datë 27.6.2018, shoqëria "DON – UCD" sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimin e energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë "DON – UCB" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "b" dhe "c"). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 4.8, germa "a" (sasia e energjisë elektrike të parashikuar për t'u tregtuar) do t'i kërkohet subjektit që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", që t'i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "DON – UCD" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë